



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Raporti i procesit tarifor 2026 – 2028

Mars 2026

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve Ujore të Kosovës

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

Mesazhi i Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) ka kënaqësinë të publikojë dhe të ndajë me publikun raportin e procesit tarifor, përkatësisht raportin e përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit për shtatë (7) Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU) në Kosovë. Tarifat e reja do të jenë të zbatueshme për 3 vitet e ardhshme 2026-2028 dhe do të hyjnë në fuqi nga 1 janari 2026. Në këtë dokument janë përshkruar në mënyrë kronologjike hapat e përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit.

Siç definohet në kornizën ligjore dhe rregullatore, roli i ARRU si autoritet i pavarur, është të balancojë interesat konsumatorëve që marrin shërbimet e ujit me nevojën për të ruajtur integritetin dhe qëndrueshmërinë financiare të KRU-ve. ARRU ka obligim dhe përgjegjësi të sigurojë që KRU-të të funksionojnë në mënyrë sa më efikase, të financojnë siç duhet aktivitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve dhe të mirëmbajnë nivelin adekuat të shërbimeve. Pra, përmes këtij procesi synohet balancimi i kostove reale të shërbimeve të ofruara dhe trajtimit të drejtë të gjithë konsumatorëve.

Rishikimi dhe përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit mbështetet në analizë të detajuar financiare, vlerësim të kostove operative, investimeve kapitale të planifikuara, si dhe në projeksione të zhvillimit afat shkurtër dhe afatmesëm të KRU-ve. Gjatë gjithë kohës, procesi i përcaktimit të tarifave të shërbimit është ndërtuar mbi parimet e transparencës, llogaridhënies dhe konsultimit me palët e interesit. Ky dokument paraqet bazën metodologjike dhe kronologjike të procesit tarifor 2026-2028, jep arsyetimin ekonomik dhe paraqet kriteret e ndjekura për përcaktimin e tarifave, duke shërbyer si një instrument orientues për zbatimin e tyre të qëndrueshëm dhe të monitorueshëm.

Duhet potencuar se gjatë këtij cikli tarifor ka pasur një rritje më të theksuar të tarifave të shërbimeve të ujit, krahasuar me ciklet paraprake tarifore. Ndër faktorët kryesor për rritjen e tarifave të shërbimeve të ujit janë rritja enorme e tarifave të energjisë elektrike, pas kalimit të KRU-ve në tregun e lirë të energjisë. Shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura janë aktivitete që konsumojnë sasi relativisht të lartë të energjisë. Gjatë muajve maj-dhjetor 2025, që korrespondon me periudhën e kalimit në tregun e lirë të energjisë, faturat e energjisë ishin rritur më shumë se 150%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Para rritjes së fundit të tarifave, energjia elektrike përbënte përkatësisht midis 10 deri 18% të shpenzimeve operative, ndërsa pas kalimit në tregun e lirë të energjisë kjo pjesëmarrje është rritur midis 20 deri 38%. Faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në tarifa të shërbimit, ka qenë rritja e investimeve për përtëritje të infrastrukturës nga burimet vetjake të KRU-ve dhe futja në operim e impianteve për përpunimin e ujërave të ndotura.

Në këtë cikël tarifor ARRU ka zbatuar një metodologji të re, e cila përfshinë disa risi, për të cilat ARRU beson se do të jenë pozitive dhe në mbrojtje të konsumatorëve. Për nevojë të publikut vlen të përmenden çështjet vijuese, që fillojnë së zbatuari prej këtij procesi tarifor e tutje:

- **Aplikimi i tarifave fikse bazuar në diametrin e gypit të kyçjes apo diametrin e ujëmatësit:** Struktura tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet ujërave të ndotura përbëhet nga një kombinim tarifash fikse dhe volumetrike. Nga ky proces tarifor e tutje, tarifa fikse do përcaktohet në përputhje me madhësinë e gypit të kyçjes apo ujëmatësit. Sa më i madh diametri i gypit të kyçjes / ujëmatësit, tarifa fikse do të jetë më e lartë.
- **Kompensimi për investimet kapitale të pa realizuara nga KRU-të:** Në të kaluarën, KRU-të nuk kanë realizuar plotësisht investimet kapitale që kanë qenë të përfshira në tarifa. Konsumatorët nuk kanë marr gjithëherë atë për të cilën kanë paguar, prandaj, ARRU ka vendosur t'i jap fund kësaj praktike. Planet e investimeve tani i nënshtrohen një niveli shumë më rigoroz shqyrtimi; atëherë kur jemi të bindur se investimet janë të përealizueshme, ARRU i zvogëlon investimet për të qenë në përputhje me nivelin e investimeve që KRU-të kanë demonstruar në të kaluarën si të arritshme. Nëse realizimi i investimeve aktuale rezulton të jetë më i ulët, sesa ishte propozuar, rishikimi pasuesi tarifor, do të përfshijë një zbritje në tarifa, për të reflektuar atë që konsumatorët kanë paguar por nuk u është ofruar. Në të kundërtën, nëse investimi rezulton të jetë më i madh sesa ishte propozuar dhe është i dokumentuar, rishikimi pasuesi i tarifave do të përfshijë një rritje për të reflektuar investimin shtesë.
- **Humbjet e ujit:** Vazhdojnë të jenë një çështje kryesore për të cilën KRU-të nuk kanë bërë përparim përgjatë viteve, prandaj, në planet e tyre janë përfshirë objektiva realiste por sfiduese të reduktimit të humbjeve. Tarifat për furnizim me ujë dhe të shërbimeve të ujërave të ndotura, do të bazohen në një pritshmëri për rritje të eficiencës për zvogëlimin e humbjeve të dukshme (komerciale), që do të reflektoheshin me tarifa më të ulëta. ARRU pret që KRU-të, të bëjnë përpjekjet më të mëdha, për të ulur

humbjet reale (teknike) në nivelin ekonomik të humbjeve dhe do të aplikohen masa ndëshkuese, nëse vlerësohet se KRU-të nuk po e arrijnë këto objektiva.

- **Tarifa për mbingarkesë (përforcim) të infrastrukturës:** ARRU ka prezantuar një tarifë për mbingarkesën (përforcimin) e infrastrukturës për çdo konsumator të ri, dhe kërkon që ata të kontribuojnë në çdo shpenzim për mbingarkesën e rrjetit që shkaktohet nga kërkesa shtesë që i atribuohet zhvillimeve të reja urbane. Në përcaktimet e kaluara të tarifave, kostoja e mbingarkesës (përforcimit) të rrjetit mbulohej edhe mbi konsumatorët ekzistues, gjë që e konsideruar si të padrejtë. Rrjedhimisht, ky vendim do të ulë paksa barrën financiare për konsumatorët ekzistues.
- **Aplikimi i tarifave të bazuara në kualitetin e ujërave të ndotura të shkarkuara:** Nga ky proces tarifor në disa regjione ka filluar së aplikuar tarifa të bazuara në cilësinë e ujërave të ndotura të shkarkuara, e cila imponon tarifa më të larta të ujërave të ndotura për kategorinë e konsumatorëve biznes - industri që vlerësohet të kenë ngarkesë më të madhe ndotëse se sa kategoritë tjera të konsumatorëve. , të cilat reduktojnë tarifat për të gjithë të tjerët ku kjo aplikohet.

Megjithëse rritja e tarifave për shërbimet e ujit do të jenë të padëshiruara për konsumatorët, ARRU konsideron se konsumatorët janë në gjendje t'i përballojnë këto tarifa. Tarifat e furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura në Kosovë janë ende nga më të ulëtat krahasuar me të gjitha shtetet tjera evropiane. Në planin afatgjatë, tarifat e shërbimit të ujit do të rriten më tej nëse konsumatorët duan të kenë nivel më të lartë të shërbimeve. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur flasim për domosdonë e zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe nevojës për investimeve afatgjata në infrastrukturën e ujërave të ndotur për të përmbushur kërkesat mjedisore të BE-së.

Falënderimet për të gjithë stafin e ARRU dhe të palëve tjera të interesit që kanë dhënë kontribut në rishikimin e metodologjisë së re tarifore, për të gjithë ata që kanë ofruar mbështetje për procesin e përcaktimit të tarifave; në veçanti falënderimet shkojnë për konsulentin Keith Burewell i përfshirë për rishikimin e metodologjisë tarifore, dhe për Bankën Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau – KfW) që ka mbështetur financiarisht konsulentin ndërkombëtar.

Faleminderit,

Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve Ujore të Kosovës (ARRU)

2026-2028 Raporti i përcaktimit të tarifave

Mars 2026

Përmbajtja

Mesazhi i Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit	iii
1 Procesi i përcaktimit të tarifave 2026-2028.....	1
1.1 Përgjegjësia e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU)	1
1.2 Historiku i proceseve të përcaktimit të tarifave	1
1.3 Mjetet rregullatore të përditësuara (modifikuara)	5
1.4 Pritshmëritë e ARRU	6
2 Metodologjia e përcaktimit të tarifave	7
2.1 Përmbledhje	7
2.2 Përmbledhje e kërkesës për të hyra	7
2.3 Kategoritë dhe aktivitetet e shërbimeve	8
2.4 Shpenzimet operative.....	8
2.5 Investimi kapital	9
2.6 Baza rregullatore e asetëve (BRRA)	10
2.7 Kthimi në bazën rregullatore të asetëve	11
2.8 Shitjet e ujit për përcaktimin e tarifave të bazuara në vëllim	11
2.9 Struktura tarifore.....	11
2.10 Përcaktimi i tarifave volumetrike për shërbimet e ujës-jellësit.....	12
2.11 Përcaktimi i tarifës volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura	12
3 Aplikacionet tarifore 2026-2028 të KRU-ve dhe vendimet e ARRU-së	14
3.1 Aplikacionet tarifore	14
3.2 Sfidimi i aplikacioneve tarifore	14
3.3 Zvogëlimi i humbjeve të dukshme	14
3.4 Sfidimi i shpenzimeve operative.....	14
3.5 Investimet kapitale duke përfshirë përtëritjen e infrastrukturës	17
3.6 Rregullime të tjera	19
3.7 Kthimi nga baza rregullatore e asetëve (BRRA)	19
3.8 Ndikimi i përgjithshëm i sfidimeve të ARRU në aplikacionet e KRU-ve	20
4 Përcaktimet rregullatore të procesit tarifor 2026-2028	26
4.1 Çmimet reale	26
4.2 Tarifat fikse mujore	26
4.3 Tarifat e mbingarkesës (përforsimit) të infrastrukturës	26
4.4 Tarifat volumetrike	26
4.5 Tarifat e efluentëve tregtare	29

Shtojca 1 Kthimi në BRR	30
Shtojca 2 Udhëzimet për tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës	34
Shtojca 3: Analiza e kostove operative, uji dhe ujërat e ndotura	38
Shtojca 4 Analiza e rinovimeve të infrastrukturës (ujë)	42
Shtojca 5 Analiza e përtëritjes së infrastrukturës (ujërat e ndotura)	43
Shtojca 6. Analiza e investimeve kapitale (ujë)	44
Shtojca 7. Analiza e investimeve kapitale (ujëra të ndotur)	45
Shtojca 8 Ndikimi i përgjithshëm tarifor i rregullimeve të ARRU-së (ujë)	46
Shtojca 9 Ndikimi i përgjithshëm tarifor i rregullimeve të ARRU-së (ujëra të ndotur)	47

1 Procesi i përcaktimit të tarifave 2026-2028

1.1 Përgjegjësia e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU)

- 1.1 Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit në Kosovë (ARRU) është rregullatori ekonomik për shërbimet e ujit në Kosovë, me përgjegjësi ligjore të përcaktojë tarifën për shërbimet e ujit për shtatë kompanitë rajonale të ujësjellësit (KRU) dhe për “NHE Iber Lepenci” sh.a. furnizuesin e ujit me shumicë të pa-përpunuar.
- 1.2 Ligjin Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të Ujit dhe Ligji Nr. 06/l-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Legjislacioni tjetër relevant që konsiderohet është:
 - Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
 - Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
 - Udhëzimi Administrativ për Cilësinë e Ujit të Pijshëm 16/2012.
 - Udhëzimi Administrativ (MESPI) nr. 02 2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufitare të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin publik të kanalizimeve
 - Rregullore Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë
 - Rregullore Nr. 16/2025 për licencimin dhe kushtet e licencës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë
 - Rregullore Nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë
- 1.3 Parimi kryesor në zbatimin e mandatit rregullator është të sigurojë që KRU-të të mund të arkëtojnë të ardhura të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e tyre, në përputhje me detyrimin ligjor për përmbushje të nivelit dhe standardeve të shërbimit, duke siguruar që konsumatorët të mos paguajnë më shumë se sa është e nevojshme dhe që konsumatorët e cenueshëm të mbrohen në mënyrë adekuate. Vendimmarrja e ARRU-së gjithashtu merr parasysh ndikimet në ekonominë e së shkallës, dhe për mbrojtje të mjedisit.

1.2 Historiku i proceseve të përcaktimit të tarifave

- 1.4 Ligji për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe Rregullorja për përcaktimin e tarifave kanë vendosur politika dhe parime të qarta për përcaktimin e tarifave. Që nga viti 2009 ARRU ka përcaktuar tarifa në baza trevjeçare, përveç vitit 2021 për shkak të pandemisë dhe vitit 2025 për shkak të ndryshimeve madhore të metodologjisë tarifore, kur janë përcaktuar tarifën vetëm për 1 vit.
- 1.5 Rishikimi i parë trevjeçar i tarifave për shërbimet e ujit (2009 – 2011) ishte një proces relativisht i thjeshtë, më pas për procesin tarifor 2012 – 2014 u zhvillua një metodologji më komplekse. Megjithatë ishin bërë disa përmirësime të vogla në modulën tarifor, deri në vitin 2025 metodologjia ishte kryesisht e pandryshuar nga formati fillestar.
- 1.6 Arsyeimi për një proces tre-vjeçar ishte për të inkurajuar KRU-të të kenë një vizion dhe planifikim afatgjatë të aktiviteteve të tyre për të ardhmen dhe t'u japin atyre siguri se tarifën duhet të jenë të mjaftueshme për t'i financuar aktivitetet e tyre. Për të mbështetur procesin e përcaktimit të tarifave, ofruesit e shërbimeve dorëzonin në ARRU planin e biznesit të detajuar, ku përfshiheshin objektiva specifike operative dhe financiare, si dhe pritshmëria për rritje të efikasitetit. KRU-të mund të rrisnin përfitimet e tyre nëse i tejkalonin këto objektiva.
- 1.7 Modeli trevjeçar përfshin një shabllon të planit të biznesit për KRU-të, ku plotësohen të dhënat lidhur me parashikimet për numrin e konsumatorëve, kërkesat për ujë, shitjet e ujit, ujërave të ndotura të gjeneruara, tregues të performancës operative, financiare dhe komerciale, investimet dhe përmirësimin të efikasitetit. Më pas përcakton të ardhurat tarifore të nevojshme për të përmbushur këto nivele të parashikuara të performancës. ARRU shqyrton aplikacionet tarifore për t'u siguruar që:

- Aktivitetet e listuar në planet e biznesit janë të nevojshme për të përmbushur standardet e kërkuara ligjore të shërbimit dhe objektivat tjera.
 - Planet e biznesit demonstrojnë efikasitet dhe se konsumatorëve nuk u kërkohet të financojnë humbjet dhe performancën e dobët.
 - Planet janë realiste dhe të arritshme.
- 1.8 Kur është konsideruar se planet nuk i plotësojnë këto kërkesa, ARRU ka kthyer planet përsëri tek KRU që ato të ndryshojnë, ose janë sfiduar dhe ndryshuar aplikacionet tarifore për të pasqyruar atë që ARRU ka konsideruar të mjaftueshme për të përmbushur kriteret e sipërme pa ndikuar negativisht në performancë.
- 1.9 ARRU ka gjithashtu përgjegjësinë për monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimit. Si pjesë e raportimit të performancës dhe për mbështetje të modelit tarifor, është krijuar një kornizë e kontabilitetit rregullator, apo “Udhëzuesi i Kontabilitetit Rregullator (UKRR)”. UKRR e specifikon raportimin financiar për të siguruar që transaksionet financiare të mund të krahasohen me procesin e përcaktimit të tarifave. UKRR ndryshon nga kontabiliteti konvencional në mënyrën e trajtimit të vlerës së aseteve (baza rregulatore e aseteve (BRR)), zhvlerësimit të aseteve dhe aspekteve të tjera të nevojshme për përcaktimin përshtatshëm të tarifave.
- 1.10 Regjimi i përcaktimit të tarifave ka rezultuar të jetë i arsyeshëm, mjaft i fuqishëm dhe ka ruajtur integritetin financiar të KRU-ve, veçanërisht kthimin në bazën rregulatore të aseteve (BRR) që ka mbrojtur rrjedhën e parasë së KRU-ve.
- 1.11 Performanca është përmirësuar në disa fusha, por në shumë raste përmirësimi i performancës nuk i ka përmbushur pritshmëritë, veçanërisht në lidhje me përmirësimet e pritshme të efikasitetit. Shumica e objektivave të përmirësimit të efikasitetit të përcaktuara në planet e biznesit të paraqitura nga KRU-të nuk janë përmbushur në vazhdimësi, pothuaj nga të gjitha KRU-të gjatë disa proceseve rregulatore të përcaktimit të tarifave.
- 1.12 Gjatë pesë proceseve trevjeçare tarifore, BRR është rritur në mënyrë të qëndrueshme në terma realë për të gjitha KRU-të, megjithëse jo aq sa është shpresuar. KRU që kanë investuar në përmirësimin e nivelit të shërbimit ose për të zgjeruar shërbimin kanë shënuar rritje të BRR, dhe kështu përfitimi i tyre nga norma e kthimit në BRR është rritur. Anasjelltas, ato KRU që nuk kanë investuar kanë shënuar rritje shumë të vogël të BRR-së në terma realë (shih Figura 1).




Figura 1 – Rritja e bazës rregulatore të aseteve nga viti 2011 (niveli i çmimeve të vitit 2025)

- 1.13 Planet e biznesit kanë përfshirë gjithmonë një shumë të investimeve kapitale, por në fund të çdo rishikimi trevjeçar, jo të gjitha investimet e miratuara janë materializuar.

- 1.14 ARRU ka për detyrë të mbrojë integritetin dhe qëndrueshmërinë financiare të KRU-ve dhe pavarësisht performancës jo të kënaqshme, përgjigja e ARRU-së ka qenë gjithmonë e kujdesshme. Qasja rregullatore konvencionale do të kishte kërkuar zbritjen e shumës së investimeve të përcaktuara nga tarifat e aprovuara në procesin pasues tarifor. Ky koncept është i njohur si është të zbrësë nga tarifat e ardhshme paratë që konsumatorët kishin paguar për investime që nuk u realizuan. Kjo koncept njihet si “kthim mbrapsht eng. clawback”. Megjithatë kjo qasje aplikohet më lehtë për ofruesit privat të shërbimeve.
- 1.15 Në raportet vjetore të performancës, KRU-të udhëzohen dhe qortohen për dështimin e përbushjes së çaqeve dhe objektivave, megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme për t'i nxitur KRU-të të bëjnë përmirësime të rëndësishme.
- 1.16 Prandaj është e nevojshme që ARRU të ushtrojmë ndikim më të madh mbi KRU-të për të rritur nivelin e performancës, efikasitetit dhe të investimeve që përfshihen në tarifat e shërbimit.
- 1.17 Për të adresuar mos përbushjen e çaqeve tarifore, në vitin 2023 ARRU e kishte konsideruar si të domosdoshme rishikimin madhor dhe të plotë të modulit tarifor. Për këtë arsye, KRU-të kishin rënë dakord për një përcaktim tarifor njëvjeçar për vitin 2025, për të pasur kohë të mjaftueshme të rishikimit të metodologjisë tarifore për një përcaktim të ri trevjeçar për vitin 2026-2028.

Konsultimi publik

- 1.18 Procesi i rishikimit filloi me një konsultim publik të nisur në janar 2024 që përcaktoi të gjitha çështjet e identifikuara si fusha për përmirësim. Dokumenti i konsultimit publik dhe raporti mbi përgjigjet e konsultimit janë në dispozicion në ueb faqen e ARRU-së.
- 1.19 Konsultimi publik shqyrtoi një numër çështjesh dhe diskutoi problemet e identifikuara, opsionet për zgjidhje (përfshirë një vlerësim të ndikimit aty ku është e mundur) dhe pozicionin e ARRU kundrejt problemeve të identifikuara.
- 1.20 Pas shqyrtimit të përgjigjeve të konsultimit, prej nëntori 2024 deri në janar 2025 janë shkruar dhe ndarë me KRU-të vendimet lidhur me ndryshimet e propozuara, duke përfshirë edhe kërkesat për veprimet që duhej të ndërmerreshin nga KRU-të për të siguruar zbatim efektiv të tarifave të reja nga 1 janar 2026.
- 1.21 Çështjet në konsultim dhe vendimet e mëvonshme të ARRU-së përfshinin:
- 1.22 **Mbulimi i kostos – mekanizma nxitës për përmirësimin e efikasitetit operativ.** ARRU ka shqyrtuar opsionet për dhënien e stimulimeve për menaxherët dhe stafin që përbushin pritshmëritë e performancës. Ky propozim nuk është pranuar, pas konsultimit publik.
- 1.23 **Mbulimi i kostos – investimi kapital.** Çështja e investimeve të pa realizuara përfshinte opsione për të lënë mënjane fondet në të ardhurat tarifore për investime ose për të përdorur mekanizmin “të kthimit mbrapsht - clawback”. Mekanizmi i “kthimit mbrapsht – clawback” u konsiderua qasja më e përshtatshme e cila është miratuar dhe do të aplikohet në procesin tarifor 2029-2031 (shih seksionin 2.5).
- 1.24 **Reflektimi i kostos – heqja graduale e ndër subvencionimit aktual midis kategorive të konsumatorëve.** Dokumenti konsultativ propozoi një përsheptim të heqjes graduale të ndër subvencionimit nga konsumatorët komercialë tek konsumatorët shtëpiak Pas konsultimit me palët e interesit, propozimi u pranua.
- 1.25 **Reflektimi i kostos – zëvendësimi i tarifave fikse me një tarifë bazuar në madhësinë e lidhjes.** Konsultimi propozoi një largim nga praktika e deritanishme e tarifave fikse prej 1.00 euro në muaj për konsumatorët shtëpiak dhe 2.00 euro për konsumatorët jo shtëpiakë, dhe adoptimi i një skemë më reflektuese të tarifave fikse bazuar në madhësinë e lidhjes. Kjo u mbështet nga të anketuarit e konsultimit dhe po jetësohet. Po ashtu u shtua një tarifë fikse për konsumatorët që marrin vetëm shërbimet e ujërave të ndotur.

- 1.26 **Reflektimi i kostos – tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës.** Aktualisht të gjithë konsumatorët ekzistues janë përgjegjës për financimin e zgjerimit të rrjetit edhe pse ky zgjerim shkaktohet nga konsumatorët e ri, e jo nga baza ekzistuese e konsumatorëve. Konsultimi publik propozoi një mekanizëm të përdorur nga rregullatorët gjatë në botë për të vendosur një tarifë për zhvilluesit e pronave si një kontribut në përforcimin e rrjetit të shkaktuar nga veprimet e tyre. Megjithatë kjo do të impononte një kosto për zhvilluesit e pronave, ajo siguron që konsumatorët ekzistues nuk do të financojnë edhe më tërësisht zgjerimin e rrjetit përmes tarifave të tyre. Ky propozim u mbështet në konsultimin publik.
- 1.27 **Reflektimi i kostos – vlerësimi i volumit të ujërave të ndotura të shkarkuara.** Regjimi aktual i tarifave është i tillë që faturimi për ujërat e ndotur bazohet në volumin e ujit të pijshëm të furnizuar nga KRU për konsumatorët. Kjo marrëveshje është e racionale për shumicën dërrmuese të konsumatorëve, por ekziston një grup i vogël konsumatorësh shtëpiak dhe jo-shtëpiakë, tek të cilët volumi i ujërave të ndotura, nuk reflekton furnizimin me ujë; ky grup konsumatorësh shkarkojnë më shumë ujëra të ndotura në sistemin e kanalizimit, sesa që marrin ujë nga KRU (për shkak të përdorimit të burimeve të tjera alternative të ujit), ose në rastin e kundërt, marrin volum më të madh të ujit dhe shkarkojnë më pak në sistemin e ujërave të ndotura. Konsultimi publik propozoi një mekanizëm me anë të cilit konsumatorët e tillë t'i nënshtrohen një vlerësimi të bazuar realist për shkarkimin e ujërave të ndotur të gjeneruara. Edhe ky propozim është mbështetur në konsultimin publik.
- 1.28 **Reflektimi i kostos – tarifat e ujërave të ndotura bazuar në vëllimin dhe cilësinë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.** Deri në vitin 2025 tarifat e ujërave të ndotura ishin uniforme, pavarësisht nga cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara. Disa konsumatorë jo-shtëpiakë shkarkojnë ujëra shumë më të ndotura, se sa cilësia mesatare e ujërave të ndotura dhe si të tillë imponojnë kosto më të madhe për m³ për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të kanalizimit dhe përpunimit në impiante. Rrjedhimisht, konsumatorët shtëpiak po subvencionojnë industri të tilla me ndotje të lartë. Konsultimi publik propozoi një qasje më reflektuese të kostos siç përdoret nga shumë shoqëri që vendosin tarifa, bazuar në koston e trajtimit të ujërave të ndotura për njësi ndotëse. Duke vendosur tarifa më të larta për industrinë më ndotëse, zvogëlon tarifën për të gjithë konsumatorët e tjerë, përfshirë amvisërinë. Kjo u mbështet në konsultimin publik dhe po zbatohet. KRU-të mund të aplikojnë në ARRU, për t'u përjashtuar nga kjo kërkesë nëse besojnë se përfitimet janë shumë të vogla për të justifikuar futjen e saj në sistemet e tyre. Aplikime të tilla duhet të mbështeten me prova.
- 1.29 **Kthimi në BRRRA – si pjesë e kontrollit njëvjeçar të çmimeve për vitin 2025 ARRU ka marrë parasysh kthimin në BRRRA që do të lejohej në përcaktimet tarifore.** Që nga viti 2021, kur u ndërmor procesi tarifor për vitin 2022-2024, normat e interesit ishin rritur dhe u krijua mundësia për rregullimin e kthimit në BRRRA. Pas një vlerësimi të detajuar, ARRU ka vendosur që norma e kthimit në BRRRA duhet të rritet nga 4.0% në 4.25% (real) për KRU Prishtina, ndërsa për gjashtë KRU-të më të vogla është vendosur të lejohet një prim rreziku shtesë prej 1.00 %, pra një normë efektive e kthimit në BRRRA prej 5.25 % (real).
- 1.30 **Hapja e Bazës Rregullore të Aseteve (BRRRA) – rivlerësimi i vlerës së BRRRA.** Vlera fillestare e BRRRA-së u përcaktua në periudhën e shqyrtimit të tarifor 2009-2011 dhe është rregulluar në çdo periudhë të rishikimit tarifor që nga ajo kohë për të përfshirë të gjitha investimet e mëvonshme minus zhvlerësimin. Në vitin 2025 KRU Mitrovica ka marrë nën menaxhim 4 komunat të reja, KRU Hidromorava ka marrë po ashtu në menaxhim 4 komuna të reja, KRU Bifurkacioni ka marrë në menaxhim 2 komuna të reja dhe KRU Hidroregjioni Jugor ka marrë nën menaxhim 1 komunë të re. Duke qenë se tek këto KRU do të ketë një rritje të konsiderueshme të numrit të konsumatorëve është vlerësuar e nevojshme që të hapet BRRRA dhe të rritet proporcionalisht me numrin e shtuar të konsumatorëve tek këto 4 KRU.
- 1.31 **Humbjet e ujit - Humbjet e ujit në industrinë e ujit në Kosovë janë një çështje shqetësuese për qeverinë, investitorët dhe ARRU-në.** Deri më tani ne e kemi konsideruar çështjen e humbjeve si një çështje menaxhimi dhe roli ynë ka qenë të ushtrojmë presion mbi KRU-të për të menaxhuar sistemet e tyre që të jenë sa më efikase që të jetë e mundur, duke përfshirë reduktimin e humbjeve në nivele ekonomikisht efikase. Deri më tani humbjet nuk janë paraqitur në procesin e përcaktimit të tarifave pasi ishte praktikisht e pamundur të përcaktoheshin nivelet ekonomikisht efikase, derisa KRU-të të kishin vendosur aparaturën hidroteknike të nevojshme në rrjetet e tyre. Pavarësisht përpjekjeve tona

të përsëritura për t'i bërë KRU-të të marrin të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur këtë çështje, ata vazhdimisht kanë dështuar të bëjnë ndonjë përparim domethënës. Prandaj, ne kemi marrë pozicionin e përfshirjes së reduktimit të 'humbjeve të dukshme' në metodologjinë e përcaktimit të tarifave. Humbjet e dukshme kryesisht përfshijnë humbjet për shkak të konsumatorëve të paregjistruar dhe leximit të pasaktë të matësit (përfshirë bypass-in e matësit). Këto humbje pasqyrojnë konsumin që paguhet nga të gjithë konsumatorët e tjerë. Qasja jonë tani përfshin një pritshmëri për një reduktim të humbjeve të dukshme që rezultojnë nga rregullimi i konsumatorëve aktualë të paregjistruar dhe një rritje të konsumit mesatar të matur familjar për të pasqyruar përpjekjet për të riparuar dhe/ose zëvendësuar matësit e dëmtuar. Ne presim të shohim në paraqitjet e planit të biznesit pritshmëri sfiduese, por gjithsesi realiste, për një rritje të konsumit mesatar dhe numrit të konsumatorëve që reflektojnë përpjekjet për të reduktuar humbjet e dukshme. Këto reduktime do të kenë efektin e zbritjes së tarifave për konsumatorët ekzistues. Kur konsiderojmë se KRU-të mund të bëjnë më mirë sesa deklarojnë në projeksionet e tyre, ne do të rezervojmë të drejtën për të ndryshuar projeksionet në përputhje me rrethanat. Pozicioni ynë në lidhje me humbjet u përcaktua në letrën tonë të datës 25 nëntor 2024.

- 1.32 **Shumat e mëdha të parave të mbajtura në llogari nga KRU-të.** Në qershor 2025 ne iu drejtuam KRU-ve duke shprehur shqetësimin tonë për burimet e konsiderueshme të parave të mbajtura në llogari. Monitorimi ynë i performancës financiare të KRU-ve kishte identifikuar se gjatë disa viteve KRU-të kanë grumbulluar burime të konsiderueshme parash të mbajtura si depozita të gatshme 'cash', por në të njëjtën kohë ata nuk kanë arritur të përmbushin investimet kapitale siç përcaktohet në planet rregullatore të biznesit. ARRU ka konsideruar se burime të tilla tejkalojnë nivelin e nevojshëm për të mirëmbajtur 'nivel të shëndetshëm të kapitalit qarkullues'. Ne deklaruar mendimin tonë se mbajtja e parave në këto nivele nuk i shërben interesave të konsumatorëve dhe as vetë KRU-ve.

1.3 Mjetet rregullatore të përditësuara (modifikuara)

Udhëzime dhe shënime rregullatore

- 1.33 Për të mbështetur shkresat (në formë vendimesh) të dërguara nga ARRU, midis nëntorit 2024 dhe janarit 2025, ne ofruam shënime udhëzuese për të ndihmuar KRU-të t'i përgjigjen siç duhet vendimeve tona. Këto përfshijnë shënime udhëzuese në lidhje me vendimet për:
- Rregullimet për tarifën e ujërave të ndotura sipas cilësisë
 - Tarifa e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës
 - Përcaktimi i kthimit në bazën rregullatore të aseteve për procesin tarifor 2025

Politika e rishikuar e tarifave

- 1.34 Vendimet e ARRU kanë kërkuar ndryshime në Politikën Tarifore të ARRU. Ky dokument u ndryshua dhe iu është dërguar KRU-ve në prill 2025.

Procedurat e rishikuara të përcaktimit të tarifave

- 1.35 Vendimet rregullatore dhe ndryshimet e mëvonshme të politikave kanë kërkuar një rishikim madhor të procedurave të përcaktimit të tarifave. Dokumenti me procedurat për përcaktimin e tarifave është dërguar gjithashtu tek KRU-të në prill 2025. Këto procedura paraqesin metodologjinë e detajuar të llogaritjes së tarifave duke përfshirë të gjitha ndryshimet që rezultojnë nga letrat e ARRU-së dhe ndryshimet e mëvonshme në politikën tarifore.

Modeli i ri i përcaktimit të tarifave dhe manuali shoqërues i modelit të përcaktimit të tarifave

- 1.36 Në qershor 2025 KRU-të u pajisën me modelin e ri të planit të biznesit të përcaktimit të tarifave dhe manualin shoqërues. Megjithëse parimet themelore të modelit të përcaktimit të tarifave janë të pandryshuara, modeli i ri konsiderohet më miqësor për përdoruesit. Modeli i ri përfshin shumë veçori të reja që rezultojnë nga vendimet e mëparshme rregullatore, p.sh. tarifën fikse bazuar në madhësitë e lidhjes, tarifën e vlerësuar të ujërave të ndotura, tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës, tarifën e bazuar në cilësinë e ujërave të ndotura dhe të tjera.

- 1.37 Ne ofruam trajnime të gjera për KRU-të në përdorimin e modelit, për t'u siguruar që ata të jenë të informuar mirë për të plotësuar kërkesat rregullatorë me saktësi.

Udhëzimet e rishikuara të kontabilitetit rregullator (UKRR)

- 1.38 UKRR do të rishikohet pas këtij rishikimi aktual trevjeçar për të marrë parasysh veçoritë shtesë që rrjedhin nga rezultatet e ndryshimeve të prezantuara pas konsultimit publik. Këto do të lëshohen menjëherë pas hyrjes në fuqi të tarifave të reja për vitin 2026.

1.4 Pritshmëritë e ARRU

- 1.39 Pas finalizimit të politikave të reja tarifore, të procedurave të rishikuara për përcaktimin e tarifave, udhëzimet e detajuara dhe modelin e ri tarifor, ARRU ka pritur që KRU-të të përgatitin planet e tyre të biznesit në mënyrë profesionale. Pritshmëria e ARRU janë qartësuar në shkresën të drejtuar KRU-ve (23 dhjetor 2024), e cila potenconte se aplikacionet tarifore duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Përafrimi i planit rregullator të biznesit me planin e biznesit siç është dorëzuar në Qeveri.
2. Plani i menaxhimit të aseteve i reflektuar dhe integruar në planin e biznesit, që të jetë realist me një probabilitet të lartë për t'u realizuar plotësisht.
3. Plani operativ të jetë realist me një gjasë të lartë për t'u realizuar plotësisht.
4. Plani komercial të jetë realist me një gjasë të lartë për t'u realizuar plotësisht.
5. Plani financiar të jetë realist dhe të përfshijë përmirësimet e pritshme të efikasitetit.
6. Objektivat për përmirësimin e nivelit të shërbimeve të jenë të fokusuar në përfitimet e konsumatorit dhe se objektivat kanë një gjasë të lartë për t'u realizuar.
7. Plani të marrë në konsideratë ndikimin e aktiviteteve të KRU në mjedis dhe merr masa për të zbutur çdo ndikim negativ.

- 1.40 Pritshmëria më e rëndësishme është që planet duhet të mbështeten me prova.

2 Metodologjia e përcaktimit të tarifave

2.1 Përmbledhje

- 2.1 Metodologjia e përcaktimit të tarifave e përdorur nga ARRU bazohet në një koncept standard rregullator të përcaktimit të një kërkesë për të hyra që është e mjaftueshme për të përmbushur financimin efikas të aktiviteteve të KRU-ve në përputhje me detyrimet ligjore të ARRU në lidhje me standardet e shërbimit dhe përmbushjen rregullatore të pritshmërive të nivelit të shërbimit.
- 2.2 Metodologjia bazohet në qasjen rregullatore të përdorur zakonisht për përcaktimin e kërkesës për të hyra të nevojshme gjatë periudhës së rishikimit dhe pastaj shpërndarjen e tyre në tarifa në mënyrë që kërkesa për të hyra të përmbushet.
- 2.3 Kërkesa për të hyra përfaqëson të hyrat e kërkuara nga KRU-të për të financuar aktivitetet e tyre duke përfshirë programet e tyre të investimeve. Ajo llogaritet në baza vjetore në terma realë në nivelet e çmimeve të vitit bazë. Komponentët kryesorë të kërkesës për të hyra janë:
- Shpenzimet operative.
 - Shpenzimet për mirëmbajtjen kapitale, duke përfshirë përtëritjen e infrastrukturës për rrjetin shpërndarës (nëntokësor) dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet jo –infrastrukturore (mbi tokësore).
 - Një kthim para tatimit në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA).
- 2.4 Koncepti i përcaktimit të tarifave bazohet në përcaktimin e tarifave për çdo vit të periudhës së procesit tarifor që do të sigurojnë një rrjedhë të ardhurash ekuivalente me kërkesën për të hyra.
- 2.5 Pas zbritjes së tarifave fikse, të ardhurave nga tarifat e lidhjes dhe dispozitave të tjera që nuk lidhen me vëllimin, tarifat mesatare vjetore të përcaktuara për çdo vit janë kërkesa për të hyra neto të furnizimit me ujë pjesëtuar me vëllimin e pritshëm të shitjeve të ujit për atë vit. Për tarifën e ujërave të ndotura është kërkesa për të ardhurat neto të shërbimeve të ujërave të ndotura pjesëtuar me vëllimin e shitjes së ujit tek ata konsumatorë me lidhje me ujëra të ndotura për atë vit.¹
- 2.6 Të dhënat hyrëse të kërkuara/ insertuara në modelin tarifor janë përgjegjësi e ekipeve të planifikimit të biznesit të KRU-ve. Informacioni pritët të rrjedhë nga burime të ndryshme, duke përfshirë parashikimet e performancës dhe investimeve nga KRU-të, llogaritë rregullatore, pasqyrat financiare të audituara (dhe të pa-audituar) nga KRU-të, vendimet dhe udhëzimet e ARRU-së dhe burime të tjera, p.sh. Agjencia e Statistikave të Kosovës për normën e inflacionit.

2.2 Përmbledhje e kërkesës për të hyra

- 2.7 Shpenzimet operative përfshijnë shpenzimet operative bazë të parashikuara të shërbimit dhe ndryshimet neto në shpenzimet operative të lidhura me përmirësimin e cilësisë së shërbimit, zgjerimin e shërbimit dhe ndryshimet në nivelin e shërbimit. Shpenzimet operative përfshijnë gjithashtu një ndarje të shpenzimeve të parashikuara të centralizuara dhe të përgjithshme.
- 2.8 Mirëmbajtja kapitale përfshin shpenzimet afatgjata për ruajtjen e shërbyeshmërisë së aseteve përmes riparimit ose zëvendësimit të madh. Kjo përfshin shpenzimet e përtëritjes së infrastrukturës për asetet nëntokësore (infrastrukturore) dhe një provizion për zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet mbi tokë (jo-infrastrukturë).²
- 2.9 Kthimi në kapital është kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA). BRRRA përcaktohet nga vlera e hapjes për çdo vit dhe shpenzimet kapitale pasuese që barten në BRRRA (përmirësimi i

¹ Shitjet e ujit për qëllime të përcaktimit të tarifave të ujërave të ndotura përfshijnë shitjet e vlerësuara për ata konsumatorë për të cilët furnizimi me ujë KRU nuk reflekton ujërat e ndotura të krijuara.

² Kontabiliteti akrual për qëllime të llogarive rregullatore është indeksimi i shpenzimeve, vlerave të aseteve dhe provizioneve të zhvlerësimin në përputhje me indeksin e publikuar të inflacionit për Kosovën. Qasja alternative moderne e vlerave ekuivalente të aseteve (AMVE) nuk zbatohet për përcaktimin e tarifave.

infrastrukturës, mirëmbajtja e kapitalit jo-infrastrukturor dhe përmirësimi jo-infrastrukturor) neto nga zhvlerësimi, asgjësimi dhe grantet e kontributet, të indeksuara në nivelet e çmimeve të vitit bazë.

- 2.10 Norma e kthimit në BRRRA është përcaktuar nga ARRU si 4.25% për KRU Prishtina. Për gjashtë KRU-të tjera më të vogla, kthimi nga BRRRA do të jetë 5.25% që përfshin një prim prej 1% për të pasqyruar kostot e tyre më të larta të financimit.

2.3 Kategoritë dhe aktivitetet e shërbimeve

- 2.11 Shpenzimet e parashikuara operative dhe investuese do të regjistrohen se i përkasin njërës prej dy kategorive kryesore të shërbimeve:

1. Shërbimet e ujësjellësit.
2. Shërbimet e ujërave të ndotura.

- 2.12 Shpenzimet e shërbimeve të furnizimit me ujë ndahen në:

- a. Shpenzimet direkte që përfshijnë:
 - i. Burimet dhe trajtimi
 - ii. Shpërndarja
- b. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
 - i. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet ndaj klientit, shpenzimet e përgjithshme etj.)

- 2.13 Shpenzimet e shërbimeve të ujërave të ndotura ndahen në:

- a. Shpenzimet direkte të përbëra nga
 - i. Grumbullimi i ujërave të ndotura
 - ii. Trajtimi i ujërave të ndotura
 - iii. Trajtimi dhe asgjësimi i llumit
- b. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
 - i. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet ndaj klientit, shpenzimet e përgjithshme etj.)

2.4 Shpenzimet operative

- 2.14 Shpenzimet operative të parashikuara pa grantet do të barten në kërkesën për të hyra. KRU-ve u kërkohet të demonstrojnë se shpenzimet e parashikuara janë të justifikuar dhe efikase. Pozicioni i ARRU është se pa ndryshime materiale në mjedisin operativ, efikasiteti i përmirësuar duhet të nënkuptojë që shpenzimet operative për njësi (shpenzimet e trajtimit për m³ ujë të prodhuar, shpenzimet e rrjetit për km tubacion dhe aktivitetet e biznesit për konsumator) duhet të bien në terma realë me kalimin e kohës. Kur KRU-të paraqesin rritje reale të shpenzimeve operative për njësi, ato pritet t'i justifikojnë ato, p.sh. shpenzimet shtesë operative të nevojshme për të përmirësuar nivelet e shërbimit.

- 2.15 Projektionet e shpenzimeve operative mund të marrin parasysh pritshmëritë e ndryshimeve të njohura të çmimeve në të ardhmen për aq sa ato ka të ngjarë të ndikojnë në kërkesën e përgjithshme për të hyra të KRU në lidhje me indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK). Rritje të tilla do të konsiderohen vetëm nëse ARRU i konsideron ato të mjaftueshme për të pasur një ndikim material në qëndrueshmërinë financiare të KRU-ve. Në këtë drejtim, ne jemi të vetëdijshëm për një rritje të konsiderueshme të tarifave të energjisë elektrike për shkak të vendimit të fundit për liberalizimin e tregut të energjisë për konsumatorët e mëdhenj, përfshirë KRU-të që janë marrë parasysh në këto përcaktime.

- 2.16 Të ardhurat nga tarifat e lidhjes konsiderohen si një kontribut i koston operative dhe zbriten nga kërkesa për të hyra në përcaktimin e kërkesës për të hyra neto.

2.5 Investimi kapital

- 2.17 Në industrinë e ujit dhe ujërave të ndotura bëhet një dallim për qëllime rregullatore ndërmjet:
- **Asetet e infrastrukturës:** Asetet që kanë një jetë të pacaktuar të përdorimit dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë adekuate, duke përfshirë zëvendësimin dhe riparimin e madh të komponentëve nga koha (mirëmbajtja e kapitalit), mund të pritet të ofrojnë një nivel shërbimi për klientët për një periudhë të pacaktuar.
 - **Asetet jo-infrastrukturore:** Asetet ku jetëgjatësia është e përcaktueshme dhe mund të pritet të asgjësohen ose zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre të pritshme. Këto asete i nënshtrohen zhvlerësimit sipas kostos aktuale gjatë jetës së tyre të pritshme.
- 2.18 Investimet në asetet infrastrukture dhe jo-infrastrukturore kontribuojnë në kërkesën për të hyra në mënyrë të ndryshme.
- 2.19 Investimet e planifikuara të mirëmbajtjes kapitale për asetet e infrastrukturës ndikojnë direkt në tarifë pasi përtëritja e infrastrukturës është ekuivalenti i zhvlerësimit. Rrjedhimisht, vlera e aseteve të infrastrukturës ruhet në si e përhershme. Investimet në rritjen e aseteve të infrastrukturës, zgjerimin / përforcimin për të përballuar konsumin shtesë të ujit, përmirësimin e niveleve të shërbimit ose përmirësimin e cilësisë së ujit i shtohen BRRRA dhe vlera e tyre e rritur ruhet përherë. BRRRA, përfshin BRRRA fillestare plus çdo investim shtesë (por pa zbritur zhvlerësimin), rregullohet për inflacionin në çdo periudhë të procesit tarifor. BRRRA e rregulluar me inflacion i nënshtrohet një kthimi i cili kalon në kërkesën për të hyra.
- 2.20 Mirëmbajtja e planifikuar e kapitalit të grupit të aseteve jo-infrastrukturore i nënshtrohet zhvlerësimit sipas kostos aktuale që përfshihet në kërkesën për të hyra. Shpenzimet aktuale për investime kapitale për asetet jo-infrastrukturore (mirëmbajtja dhe rritja e kapitalit) i shtohen BRRRA dhe përshtaten me inflacion në çdo periudhë të procesit tarifor. BRRRA e rregulluar me inflacion i nënshtrohet një kthimi i cili kalon në kërkesën për të hyra.
- 2.21 Grantet për investime kapitale zakonisht paguhen nga subvencioni qeveritar ose nga agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit. ARRU miraton qasjen e kapitalit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) për grantet në atë që asetet e financuara nga grantet nuk shtohen në BRRRA dhe zhvlerësimi i tyre nuk aplikohet.
- 2.22 ARRU ka prezantuar tarifa të mbingarkesës (përforcimin) së infrastrukturës. Këto janë tarifa për të pasqyruar efektin kumulativ afatgjatë të konsumatorëve të rinj neto, që shkaktojnë nevojën për përforcim të infrastrukturës. ARRU konsideron se ky përforcim nuk duhet të financohet nga baza ekzistuese e konsumatorëve përmes tarifave, por nga zhvilluesit që krijuan nevojën për një përforcim të tillë. Kjo tarifë është një kontribut kapital për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës. Kjo do të thotë që shtesa në BRRRA për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës nuk merr për bazë të hyrat nga tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës. Kur të ardhurat nga tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës janë më të mëdha se shpenzimet vjetore për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës, BRRRA do të reduktohet, duke u trajtuar efektivisht si një paradhënie kundrejt investimeve të ardhshme në rritje/zgjerim.
- 2.23 Gjatë vitit 2028 deri në procesin tarifor 2029-2031, ARRU do të balancojë investimin aktual me investimet e miratuara gjatë viteve 2026-2028. Ky proces balancimi, i referuar si 'clawback', do të përcaktojë shumën e parave që konsumatorët kanë paguar për investime që nuk janë realizuar. Kjo përfshin:
- Investimet e përtëritjes së infrastrukturës të përfshira në plan dhe të realizuara.
 - Kthimi në BRRRA të investimeve për përmirësimin e infrastrukturës të përfshira në plan dhe të realizuara.
 - Zhvlerësimi sipas kostos aktuale për investimet jo-infrastrukturore të përfshira në plan dhe të realizuara.
 - Kthimi në BRRRA të investimeve jo-infrastrukturore të përfshira në plan dhe të realizuara.

- Një rregullim për të pasqyruar koston e kapitalit që KRU-të kanë përfituar gjatë kësaj periudhe për investimet e pa realizuara.
- 2.24 Shumat e mbi-paguara nga konsumatorët për investime të pa realizuara do të përfshihen si vlerë negative në kërkesën për të hyra të shpërndara në tre vitet e përcaktimit të tarifave 2029-2031. Kjo është diçka që nuk është zbatuar në proceset e kaluara tarifore, por ne konsiderojmë se butësia e treguar në të kaluarën nuk mund të lejohet të vazhdojë për një kohë të pacaktuar.
- 2.25 Ky proces i kthimit funksionon edhe anasjelltas, d.m.th. nëse KRU-të investojnë më shumë sesa përcaktohet në planet e tyre, balancimi do të rezultojë në një vlerë pozitive të bartur në kërkesën e të ardhurave 2029-2031, me kusht që ne të jemi të kënaqur se investimi ishte i nevojshëm dhe efikas.

2.6 Baza rregullatore e asetëve (BRR)

- 2.26 BRR përfaqëson bazën e kapitalit mbi të cilën KRU-të kanë të drejtë për një kthim. BRR përfaqëson nivelin e investimeve të financuara nga burimet financiare të KRU-ve, investimet prej ekuitetit dhe përmes kredive. BRR është caktuar në vitin 2009 dhe pastaj janë shtuar investimet kapitale pasuese (ndër vite) pa zhvlerësim dhe pa grante, të indeksuara në nivelet e çmimeve të vitit bazë. BRR rregullohet në çdo proces tarifor për të përfshirë shtesat (investime të reja), zbritjet (zhvlerësimin dhe asgjësimin) dhe rregullohet nga indekset e inflacionit nga niveli i çmimeve në një vit bazë të procesit tarifor në nivelin e çmimeve në vitin bazë të ardhshëm. Kjo shpjegohet më në detaje në udhëzimet e kontabilitetit rregullator (UKRR).
- 2.27 Investimet kapitale në jo-infrastrukturorë i shtohen bazës rregullatore të asetëve duke iu zbritur zhvlerësimi sipas kostos aktuale nga baza rregullatore e asetëve.
- 2.28 Investimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës shtohen në bazën rregullatore të asetëve dhe vlera e saj ruhet përherë.
- 2.29 Kapitali qarkullues konsiderohet i përfshirë në bazën rregullatore të asetëve dhe nuk bëhen rregullime për ndryshimet në kapitalin qarkullues.
- 2.30 Shpenzimet e përtëritjes së infrastrukturës nuk shtohen në bazën rregullatore të asetëve.
- 2.31 Ky proces i përcaktimit të tarifave 2026-2028 përfshin një dispozitë për tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës që do të prezantohen për herë të parë. Kjo është një tarifë e vendosur për zhvilluesit si një kontribut për investime të reja që ndodhen jashtë vendit të zhvillimit, por shkaktohet nga efektet kumulative të zhvillimit të ri (shih Shtojca 2 Udhëzimet për tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës)). Duke qenë se ky është një kontribut në rritjen/zgjerimin e infrastrukturës, të ardhurat e mbledhura nga tarifa të tilla zbriten nga kategoria e BRR infrastrukturorë. Kur KRU-të investojnë në rritjen/zgjerimin e infrastrukturës, atëherë BRR rritet. Në planin afatgjatë, ne presim që investimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës në lidhje me bilancin e kërkesës së ofertës të financohen kryesisht nga tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës.
- 2.32 Për katër KRU, BRR është rritur për të pasqyruar ndryshime të rëndësishme në numrin e konsumatorëve që i atribuohen marrjes nën menaxhim të komunave të reja, që më parë nuk ishin përfshirë në zonat e shërbimit të KRU-ve. Kjo përfshin Mitrovicën, ku asetet e ujit dhe ujërave të ndotura të Mitrovicës së Veriut tani do të përfshihen në bazën e asetëve të KRU-së. Ndryshime të ngjashme në numrin e konsumatorëve ndodhën në tre KRU të tjera, Hidroregjioni-Jugor, Bifurkacioni dhe Hidromorava. Rritja e BRR bazohej në një rregullim të thjeshtë me popullatën që u përfshi në zonë të shërbimit. Meqenëse gati 100% e popullsisë së Kosovës tani shërbehet nga KRU-të, ne nuk parashikojmë ndryshime të ardhshme në BRR.

2.7 Kthimi në bazën rregullatore të aseteve

- 2.33 ARRU zbaton modelin e çmimit të aseteve kapitale për aq sa është e mundur në kontekstin e tregjeve financiare të Kosovës për të përcaktuar normën ose kthimin që është i përshtatshëm për sektorin e ujit në Kosovë (shih Shtojca 1 Kthimi në BRRRA).
- 2.34 Kthimi i aplikuar është një kthim 'real', pra duke përjashtuar inflacionin. Efektet e inflacionit përfshihen në tarifa përmes indeksimit të BRRRA në çdo proces tarifor, aplikimit të zhvlerësimit sipas kostos aktuale dhe indeksimit të tarifave të përcaktuara brenda një procesi tarifor. E gjithë kjo është në përputhje me teorinë konvencionale ekonomike dhe siç zbatohet nga rregullatorët nëpër sektorë të ndryshëm në vende të ndryshme të botës.
- 2.35 Kthimi aplikohet në BRRRA mesatare të çdo viti dhe i shtohet kërkesës për të hyra.

2.8 Shitjet e ujit për përcaktimin e tarifave të bazuara në vëllim

- 2.36 Projeksionet e përgjithshme të shitjeve bazohen në planet e biznesit të KRU-ve, por i nënshtrohen shqyrtimit rregullator dhe, aty ku është e përshtatshme, rregullimeve për të pasqyruar pritshmëritë e ARRU për performancë të përmirësuar.
- 2.37 Shitjet totale vjetore të pritshme të ujit (m³) përcaktohen bazuar në vlerësimet më të mira të KRU-ve për vëllimet e shitjeve të ujit duke marrë parasysh kërkesat aktuale dhe të ardhshme për ujë, pritshmëritë realiste, por megjithatë sfiduese të rritjes së shitjeve të regjistruara përmes programeve të riparimit dhe zëvendësimit të matësve dhe rregullimit të konsumatorëve aktualë të përgjithshëm. Rritja e shitjeve që rezultojnë nga riparimet dhe zëvendësimet e matësve dhe rregullimi i konsumatorëve aktualë të përgjithshëm janë masat kryesore me të cilat do të reduktohen humbjet e dukshme. ARRU pret përmirësime të konsiderueshme në shitje që rezultojnë nga këto aktivitete.
- 2.38 Vëllimet e shitjes së ujit bëjnë dallimin midis shitjeve totale të ujit dhe shitjeve të ujit tek konsumatorët me një lidhje të ujërave të ndotura që është baza për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ujërave të ndotura.
- 2.39 Shitjet e vlerësuara të ujit për qëllime të tarifimit të ujërave të ndotura përcaktohen për ata konsumatorë josthtëpiakë ku vëllimi i ujërave të ndotura të gjeneruara nuk lidhet me hyrjen e ujit nga rrjeti i KRU-së.
- 2.40 Projeksionet e shitjeve të ujit do të ndahen në kategoritë e klientëve: shtëpiakë dhe josthtëpiakë. KRU-të do të japin informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar vlerësime të arsyeshme të parashikimeve të tilla sipas kategorive.
- 2.41 Numri i parashikuar i klientëve (sipas kategorisë) për çdo vit kërkohet për të përcaktuar bazën mbi të cilën përcaktohen të ardhurat nga tarifatat e lidhjes, të ardhurat nga tarifatat fikse dhe të ardhurat nga tarifa e mbingarkesës (përforsimit) të infrastrukturës.
- 2.42 Projeksionet e shitjes së ujit sipas kategorive do të rregullohen për të pasqyruar borxhet e parikuperueshme (mospagesa). ARRU do të shqyrtojë parashtrimet dhe mund të përcaktojë një nivel alternativ të borxhit të parikuperueshëm nëse parashtrimet nuk konsiderohen mjaft sfiduese. Përqindja e shkallës së arkëtimit është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit, duke iu afruar 100% në disa raste. Për përcaktimet e ardhshme të tarifave, ne mund të konsiderojmë heqjen e borxheve të parikuperueshme nga procesi i përcaktimit të tarifave dhe ta konsiderojmë këtë si një rrezik që duhet të përballohet nga KRU-të. Për të kompensuar këtë rrezik shtesë, një rritje e vogël e kthimit të BRRRA mund të jetë e justifikueshme. Ne do ta shqyrtojmë këtë opsion në më shumë detaje dhe do të marrim një vendim përpara procesit tarifor 2029-2031.

2.9 Struktura tarifore

- 2.43 Struktura e tarifave të ujit përfshin:

- Një tarifë fikse mujore për konsumator, e cila, nga viti 2026, do të bazohet në madhësinë e lidhjes.
- Një tarifë vëllimi për m³ ujë të shitur (aktualisht tarifa të ndryshme për konsumatorët shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë).
- Një tarifë e ujit të trajtuar me shumicë (aty ku është e aplikueshme).
- Një tarifë e lidhjes për lidhje të reja.
- Një tarifë të mbingarkesës (përforcimit) së infrastrukturës për lidhjet e reja neto të ujit.

2.44 Struktura tarifore e shërbimeve të ujërave të ndotura përbëhet nga:

- Tarifa e vëllimit të ujërave të ndotura për m³ ujë të shitur për ata konsumatorë me lidhje me ujërat e ndotura (aktualisht tarifa të ndryshme për konsumatorët shtëpiakë dhe jo-shtëpiak).
- Një tarifë shtesë e ujërave të ndotura për ata konsumatorë që i nënshtrohen tarifave tregtare të ujërave të ndotura kur cilësia e ujit është materialisht e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura (opsionale).
- Një tarifë lidhjeje për lidhje të reja.
- Një tarifë të mbingarkesës (përforcimit) së infrastrukturës për lidhjet e reja neto të ujit.

2.45 Ky proces tarifor 2026-2028 përfshin për herë të parë një kërkesë që KRU-të të përdorin tarifat e efluenteve tregtare. Në disa KRU, industri të mëdha individuale dhe grupe specifike konsumatorësh gjenerojnë ujëra të ndotura me një cilësi që është dukshëm e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura. Kur cilësia e ujërave të ndotura është dukshëm më e keqe se mesatarja, ajo imponon kosto dukshëm më të larta për KRU për m³ të ujërave të ndotura sesa konsumatorët shtëpiakë. Tarifa aktuale uniforme e ujërave të ndotura rezulton në subvencionimin efektiv të konsumatorëve shtëpiakë nga jo-shtëpiakë me ndotje më të lartë. Aplikimi i tarifave të efluenteve tregtare mund të mos jetë i përshtatshëm për të gjitha KRU-të. Një KRU mund të aplikojë për përjashtimin nga kjo kërkesë nëse konsideron se kostot e një skeme të tillë tejkalojnë përfitimet ose se përfitimi i përgjithshëm është i papërfillshëm. Një kërkesë e tillë duhet të mbështetet me prova.

2.46 Tarifat shtesë të efluenteve tregtare (ose zbritjet) për konsumatorët e kualifikuar, përcaktohen duke përdorur formulën Mogden, detajet e së cilës jepen në Udhëzimet e ARRU, të lëshuara në janar 2025, për tarifat e efluenteve tregtare.

2.47 Këto tarifa do të zbatohen pavarësisht nëse konsumatori është i lidhur me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura. Kjo është për të siguruar që konsumatori po paguan për dëmin e mjedisit dhe inkurajon konsumatorin të investojë në para-trajtim nëse është ekonomikisht efikas për ta bërë këtë.

2.48 Aplikimi i këtyre tarifave të efluenteve tregtare nuk ndryshon kërkesën e përgjithshme të ardhurave dhe për këtë arsye ka efektin e uljes së tarifave për të gjithë konsumatorët e tjerë.

2.10 Përcaktimi i tarifave volumetrike për shërbimet e ujësjellësit

2.49 Tarifa e shërbimeve të ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak përcaktohet si: kërkesa për të hyra minus tarifat e lidhjes dhe tarifat fikse, pjesëtuar me vëllimin ekuivalent të ujit të shitur dhe të paguar, gjegjësisht shitjet shumëzuar me shkallën e arkëtimit të ardhurave. Kjo siguron një shkallë të vogël të hapësirës për mos-pagesën nga konsumatorët, por me kalimin e kohës ARRU mund të zgjedhë t'i konsiderojë borxhet e këqija si një çështje menaxhimi dhe jo më të përfshihen në metodologjinë e përcaktimit të tarifave.

2.11 Përcaktimi i tarifës volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura

2.50 Tarifa e shërbimeve të ujërave të ndotura për konsumatorët shtëpiak përcaktohet si: kërkesa për të hyra, minus tarifat e lidhjes dhe tarifat shtesë për tarifat e bazuara në cilësi pjesëtuar me vëllimin ekuivalent të brendshëm të ujit të shitur dhe të paguar për konsumatorët e ujërave të ndotura, pra shitjet shumëzuar me shkallën e arkëtimit të ardhurave.

- 2.51 Ky proces tarifar 2026-2028 përfshin gjithashtu, për herë të parë, objektin për të aplikuar flukset e vlerësuara të ujërave të ndotura për konsumatorë specifikë jo-shtëpiakë ku ujërat e ndotura të gjeneruara nuk janë reflektim i hyrjes së furnizimit me ujë nga rrjeti i KRU.
- 2.52 Sa i përket furnizimit me ujë, ARRU mund t'i konsiderojë borxhet e këqija si një çështje menaxhimi dhe jo më të përfshihen në metodologjinë e përcaktimit të tarifave.

3 Aplikacionet tarifore 2026-2028 të KRU-ve dhe vendimet e ARRU-së

3.1 Aplikacionet tarifore

- 3.1 KRU-ve iu kërkua të dorëzonin aplikacionet e tyre për tarifa deri më 31 gusht 2025. Më pas ishte rënë dakord për një kërkesë për zgjatjen e këtij afati deri më 20 shtator 2025.
- 3.2 Modeli i rishikuar ka një dukje të ndryshuar dhe veçori të reja janë shtuar, parimet themelore të modelit janë kryesisht të pandryshuara dhe KRU-të janë të njohur me to. Për modelin e rishikuar u ofrua trajnim intensiv për KRU-të.

3.2 Sfidimi i aplikacioneve tarifore

- 3.3 Ri-aplikimet e KRU-ve, pas shqyrtimit tonë fillestar, janë analizuar në një nivel që ne mund ta arrijmë realisht në kohën e kufizuar të disponueshme pas zgjatjes së afatit të dorëzimit. Në këtë drejtim ne jemi fokusuar në disa fusha kyçe si ndikim material në tarifat përfundimtare. Këto përfshijnë:
 - Një vlerësim i përpjekjeve për të reduktuar humbjet e dukshme përmes rregullimit të lidhjeve të paligjshme dhe pritshmërisë që konsumi për konsumator duhet të rritet me matje të përmirësuar.
 - Një vlerësim i kostove operative në raport me atë që është arritur në të kaluarën.
 - Një vlerësim i paraqitjeve të kostos së energjisë pas vendimit për liberalizimin e tregut të energjisë për përdoruesit e mëdhenj industrialë.
 - Një vlerësim i investimeve kapitale bazuar në atë që KRU-të kanë realizuar në proceset e kaluara tarifore, si realisht të arritshme.

3.3 Zvogëlimi i humbjeve të dukshme

- 3.4 Ne parashtriam në letrën tonë, të 25 nëntorit 2024, pritshmërinë tonë për një reduktim të ndjeshëm të humbjeve të dukshme. Në letër ne deklaruar se prisnim një përpjekje sfiduese, por realiste nga KRU-të, për të reduktuar këto humbje përmes një programi të rregullimit të lidhjeve të paligjshme dhe riparimit ose zëvendësimit të matësve që nuk lexojnë mirë.
- 3.5 Legalizimi i konsumatorëve të pa-regjistruar që janë të kyçur në rrjetin e furnizimit me ujë dhe që konsumojnë ujin, do të ndikojë që KRU-të të rrisin të ardhurat dhe të ulin kostot për njësi të ujit të prodhuar. Ne vlerësojmë që identifikimi i konsumatorëve të paregjistruar duhet të jetë proces i vazhdueshëm e hulumtimit të detajuar nëpër zona, që kërkon krijimin e zonave të matura të ujit (District Metered Area – DMA). ARRU në do të pranoj mos-përmbushjen e kësaj kërkesë, si justifikim për të mos legalizimin e konsumatorëve të paregjistruar në procesin e përcaktimit të tarifave.
- 3.6 Zakonisht, një program riparimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve do të rezultojë në një pritshmëri të një rritjeje të konsumit mesatar për konsumator (që faturohen me matje), pasi ujëmatësit e vjetërsuar dhe të dëmtuar përgjithësisht regjistrojnë volum më të ulët. Aktivitetet e riparimit dhe zëvendësimit të ujëmatësve mund të pritet të zvogëlojnë humbjet e dukshme midis 10-15%. Për këtë arsye ARRU do të kërkojë nga KRU-të të raportojnë për numrin e ujëmatësve të riparuar / zëvendësuar dhe të kryejnë analiza rreth ndikimit të këtyre aktiviteteve, p.sh. të dhënat e konsumit para dhe pas zëvendësimit të matësve në një zonë të caktuar (DMA), numrat e matësve të zëvendësuar dhe detaje të tjera. Kjo do të lejojë një vlerësim më të saktë të reduktimit të humbjeve të dukshme nga programi i matjes.

3.4 Sfidimi i shpenzimeve operative

- 3.7 Aplikacionet e KRU-ve për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura (duke përjashtuar kostot e energjisë) kanë treguar rritje të konsiderueshme të shpenzimeve, të rregulluara për inflacion, të cilat në pjesën më të madhe rezultojnë të pajustificuara. Rishikimi dhe vlerësimi i ARRU-së i kostove operative (duke përjashtuar energjinë) ka identifikuar zërin e shpenzimeve të personelit si faktori kryesor që shkakton rritjen e shpenzimeve operative. Çdo rritje reale në kostot operative për njësi

duhet të justifikohet si e nevojshme për të ofruar përmirësime në nivelin e shërbimit për konsumatorët. KRU-të nuk kanë dhënë ndonjë provë bindëse për të justifikuar rritjet që kanë propozuar. Në vend të rritjes së kostove operative, ARRU pret që kostot operative në raport me prodhimin dhe shitjen e ujit të ulen në terma realë me kalimin e kohës, si rezultat i përmirësimeve në efikasitet. Përkrahim bëjnë rastet kur ka ndryshime të arsyetueshme dhe substanciale në mjedisin operativ të KRU-ve, si për shembull vënia në funksion e objekteve apo kapaciteteve të reja (të përpunimit të ujit apo përpunimit të ujërave të ndotur) që gjenerojnë kosto të cilat më parë nuk kanë ekzistuar.

- 3.8 ARRU ka krahasuar kostot operative të planifikuara për njësi (duke përfshirë energjinë) për vitin bazë (viti 2025) me kostot operative aktuale për njësi të vitit 2025. Normalisht do të ishte pritur ulje e kostove reale për njësi si rezultat i përmirësimit të efikasitetit, megjithatë ARRU ka përshtatur kostot ashtu që të jenë afërsisht të njëjta me kostot e vitit 2025, të përshtatura për inflacion. Kjo mund të gjenerojë rritje ose ulje të vogla proporcionale në lejimet e përgjithshme të kostos që rezultojnë nga ndryshimet në volumet e trajtimit të ujit dhe ujërave të ndotura dhe tek numri i konsumatorëve. Në përcaktimet e ardhshme ne presim që propozimet e kostos operative të pasqyrojnë përmirësime reale në efikasitetin operativ.
- 3.9 Në disa raste, për shembull marrja nën menaxhim e asetëve dhe përgjegjësi operative të sistemeve në Mitrovicë të Veriut, në komunat në regjionin e Gjilanit, Ferizajit, futja në operim e impianteve të reja, ku pritet rritje e konsiderueshme e kostove operative është e justifikueshme dhe është marrë parasysh në shqyrtimin e aplikacioneve.
- 3.10 Aplikacionet e KRU-ve për shpenzimet operative në disa raste duket se kanë shpërndarë gabimisht kostot midis furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura. Kur është identifikuar kjo keq-shpërndarje, ARRU ka komunikuar me KRU për të modifikuar aplikacionet në përputhje me rrethanat.
- 3.11 Aplikacionet e KRU-ve përfshinin rritje të konsiderueshme (madje mbi normën e përshtatjes inflatore) të kostove të personelit, duke reflektuar ose me rritje të numrit të stafit ose rritje reale të pagave ose një kombinim i të dyjave. ARRU ka zvogëluar shpenzimet për stafin për të qenë përgjithësisht në përputhje me vlerat e audituara të vitit 2024 dhe të aprovuara të vitit 2025 (të përshtatura për inflacion), përveç rasteve kur rritje të tilla janë të justifikuara dhe të mbështetura me prova. Megjithatë, për të ruajtur që shpenzimet e përgjithshme operative të jenë në përputhje me ato të audituara të vitit 2024 dhe të aprovuara për vitin 2025, çdo zbritje ose shtesë në vlerat e kostove të stafit është rialokuar në zëra të tjerë të kostos në aplikacionet e KRU-ve për shpenzime operative.
- 3.12 Rregullimet e ARRU-së në projeksionet e propozuara të kostove operative për furnizimin me ujë (duke përfshirë energjinë) janë zvogëluar prej -9% deri -32%. Për shërbimet e ujërave të ndotura (pa përfshirë energjinë) rregullimet sillen nga -23% deri në +8%.

Kostoja e energjisë

- 3.13 Në qershor 2025 tregu i energjisë në Kosovë u liberalizua për konsumatorët e mëdhenj, duke përfshirë edhe KRU-të. Kjo ka rezultuar në rritje të konsiderueshme të kostos së energjisë prej më shumë se 150% për KRU-të. Aplikacionet për procesin tarifor 2026-2028 kanë marrë për bazë këto rritje.
- 3.14 ARRU ka marrë parasysh si prova faturat aktuale të energjisë të pranuar (dhe të paguara) nga KRU-të në vitin 2025 dhe është arritur në përfundim se një rritje prej 150% në tarifa para liberalizimit të tregut të energjisë elektrike është e justifikueshme.
- 3.15 ARRU ka parasysh se natyra e tregut të liberalizuar mund të rezultojë në luhatje më të madhe të çmimit të energjisë elektrike. Pozicioni i ARRU-së është se duke qenë se kthimi i BRRA është një kthim i bazuar në rrezik, çdo rritje e mëvonshme e kostos ose fitim i papritur nga luhatjet e çmimit të energjisë elektrike brenda periudhës tarifore 2026-2028 do të jetë në përgjegjësi të KRU-ve. Nëse

nuk paraqiten prova bindëse për të mbështetur një rishikim të jashtëzakonshëm të procesit aktual tarifor, asnjë rregullim nuk do të merret parasysh deri në procesin pasues tarifor 2029-2031.

- 3.16 Ne jemi të vetëdijshëm se rritja e çmimit të energjisë elektrike ndodhi në mes të vitit 2025 dhe këto rritje nuk ishin marrë parasysh në aplikimin për tarifa të vitit 2025. ARRU e pranon se një rritje e tillë e papritur e kostos së energjisë në vitin 2025 ka qenë goditje e paparashikuar dhe e jashtëzakonshme, dhe se shpenzimet shtesë të bëra brenda vitit 2025 janë bartur në procesin tarifor 2026-2028 të shpërndara në tre vjet dhe të rregulluara për normën e kthimit në BRRRA, pra me interes.
- 3.17 Në të ardhmen ne presim që KRU-të t'i përgjigjen këtyre rritjeve të kostove duke marrë një qasje proaktive ndaj menaxhimit të energjisë. Prandaj, presim të shohim përmirësime të rëndësishme në mënyrën se si KRU-të menaxhojnë energjinë dhe investimet në efikasitet të energjisë. Kjo përfshin investime në vetë-gjenerimin aty ku është e përshtatshme dhe aktivitete të tjera.
- 3.18 Rritja e kostos së energjisë elektrike rrit edhe koston për njësi të ujit të prodhuar. Ky fakt do të ketë një ndikim të rëndësishëm te KRU për nivelin ekonomik të humbjeve reale të ujit. ARRU pret që rritja e çmimit të energjisë elektrike të nxisë përpjekje më të mëdha për të adresuar humbjet reale të ujit. Në procesin tarifor 2029-2031 dhe më tej, ne mund të zgjedhim të konsiderojmë uljen e kostove të aprovuara të energjisë elektrike për të pasqyruar tarifën që do të bëheshin nëse KRU-të do të kishin arritur pritshmëri të arsyeshme për reduktimin e humbjeve reale.

Shpenzimet e përgjithshme operative

- 3.19 Rregullimet (zvogëlimet) e shpenzimeve totale operative të propozuara nga KRU-të për furnizim me ujë të pijshëm variojnë nga -22% në -3% me një rregullim të përgjithshëm prej -11% në 2026 në -17% në 2028. Për shërbimet e ujërave të ndotura rregullimet variojnë nga -30% në +135% me një rregullim të përgjithshëm prej +1% në 2026 dhe në -4% në 2028. Këto rregullime ilustrohen në Figura 2 dhe Figura 3.




Figura 2 – Shpenzimet totale operative të paraqitura dhe të miratuara (shërbimet e ujit)³

³ Për vitin 2024 ne raportojmë për shpenzimet operative aktuale të bëra nga KRU-të, për vitin 2025 raportojmë për shpenzimet operative të lejueshme të KRU-ve -ve pasi nuk kemi të dhëna të fundvitit për shpenzimet aktuale në vitin 2025. Për 2026 deri në 2028 raporti mbi paraqitjet e shpenzimeve operative nga KRU-të (blu e zbehtë) dhe përcaktimet tona përfundimtare për shpenzimet operative (blu më e errët).




Figura 3 – Shpenzimet totale operative të paraqitura dhe të miratuara (shërbimet e ujërave të ndotura)

- 3.20 Një analizë më e detajuar e kostove operative për KRU-të individuale paraqitet te Shtojca 3: Analiza e kostove operative, uji dhe ujërat e ndotura.

3.5 Investimet kapitale duke përfshirë përtëritjen e infrastrukturës

- 3.21 Në shkresën e 23 dhjetorit 2024, ARRU kishte potencuar domosdonë për prova për të mbështetur aplikacionet tarifore. Në rastin e investimeve kapitale, kërkesat për dëshmi dhe arsyetime të investimeve kapitale, ishin të trefishta:
- Të demonstrojë se investimi është i justifikuar në përmbushjen e nivelit të detyrueshëm të shërbimit.
 - Të demonstrojë se vlerësimet e shpenzimeve për investimet janë realiste.
 - Të demonstruar se ka një probabilitet të lartë që investimi të realizohet.
- 3.22 Dëshmitë mbështetëse në këtë aplikacion tarifor ishin përgjithësisht të dobëta. Shumica e propozimeve për investime ishin të përgjithësuara dhe jo specifike, vlerësimi i kostos së projekt propozimeve nuk është ashtu siç duhet, e mbi të gjitha nuk janë paraqitur prova bindëse, për të na dhënë siguri se me buxhetin e propozuar këto projekte do të realizohen brenda afatit kohor të paraparë.
- 3.23 Për më tepër, shuma totale e investimeve të paraqitura nga KRU-të në këtë aplikim tarifor është shumë më e madhe se shuma e investimeve që KRU-të kanë realizuar në të kaluarën, veçanërisht në lidhje me investimet në përtëritjen e infrastrukturës që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në tarifa.
- 3.24 Në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme, ARRU është përballur me tri opsione:
1. Të refuzojmë të gjitha propozimet për investime që nuk plotësojnë kriteret teknike dhe ofrimin e dëshmive bindëse së këto projekte do të realizohen. Ky opsion do të kishte për pasojë tarifa shumë të ulëta dhe do t'i privojë KRU-të të grumbullojnë financa të nevojshme për të ofruar një nivel minimal të shërbimeve.
 2. Të pranojmë propozimet për investime të listuara nga KRU-të, por kjo do të çojë në ngritje të tarifave në një periudhë afat-shkurtër (cikël tre-vjeçar tarifor). Problemi do të shfaqet nëse investimet nuk realizohen dhe futet në zbatim mekanizmi “i kthimit të investimeve të pa realizuara – clawback”, që do të kishte për pasojë uljen e ndjeshme të tarifave në procesin pasues tarifor 2029-2031.
 3. Të pranojmë një nivel investimesh i cili do të jetë i krahasueshëm me investimet që KRU-të kanë realizuar në të kaluarën. Ky opsion ofronte një qasje më realiste dhe më bindëse se investimet e

aprovuara do të realizoheshin. Tarifat do të jenë të mjaftueshme për të mirëmbajtur një nivel të kënaqshëm të mirëmbajtjes kapitale.

- 3.25 Qasja e ARRU-së për vlerësimin e propozimeve të investimeve kapitale është bazuar në aprovimin e një kombinimi të opsionit të dytë dhe të tretë. ARRU ka pranuar kryesisht propozimet e KRU-ve për investime kapitale jo-infrastrukturore, por për përtëritjen e infrastrukturës miratimet e ARRU-së bazohen në performancën e investimeve të viteve të kaluara duke iu përshtatur rrethanave të sektorit.

Investimet për përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujësjellësit

- 3.26 Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për furnizim me ujë kanë ndikim të plotë dhe të drejtpërdrejtë në kërkesat për të hyra, rrjedhimisht edhe në tarifa. ARRU ka konsideruar propozimet e KRU-ve për përtëritjen e infrastrukturës duke u bazuar në faktet dhe metodën vijuese:

1. Investimet e realizuara të përtëritjes së infrastrukturës për vitet 2022-2024 janë përshtaten me inflacionin në nivelin e çmimeve të vitit bazë (2025).
2. Zgjidhet viti më i mirë (për nga lartësia e investimeve) nga tre vitet 2022-2024.
3. Vlera e miratuar e përtëritjes së infrastrukturës për secilin nga vitet 2026-2028 është vlera e vitit më të mirë të procesit tarifor 2022-2024, duke shtuar një kompensim shtesë mbi këtë shumë.
4. Si një masë paraprake kujdesi për të evituar ndikimet potenciale në procesin pasues tarifor, është konsideruar një nivel minimal i investimeve në përtëritjen e infrastrukturës që ndër-lidhet me numrin e konsumatorëve, për t'u siguruar që të mos ketë shuma të larta të investimeve të pa-realizuara dhe të mos rrezikojmë përkeqësimin e infrastrukturës.

- 3.27 ARRU vlerëson se kjo qasje e pranimit të investimeve të ofrojë një projeksion realist të investimeve aktuale për përtëritje të infrastrukturës, dhe në këtë mënyrë do të sigurohemi që të mos ketë shuma të larta të investimeve të pa-realizuara në rast të zbatimit të mekanizmit "të kthimit të investimeve të pa realizuara – clawback" pas tre viteve.

- 3.28 Nëse KRU-të tejkalojnë nivelin e lejuar të investimeve në përtëritjen e infrastrukturës dhe nëse ARRU vlerëson se ato investime kanë qenë të nevojshme, pjesa shtesë e mjeteve të investuara nga KRU-të do të barten dhe do të njihen si të ardhura shtesë në procesin pasues tarifor 2029-2031.

- 3.29 Bazuar në qasjen e mësipërme, shuma totale investimeve në përtëritjen e infrastrukturës të kërkuara nga KRU-të për përtëritjen e infrastrukturës së furnizimit me ujë ka qenë 16.3 milionë euro, ndërsa pas vlerësimit dhe rregullimit që ka bërë ARRU kjo shumë është zvogëluar në 9.7 milionë euro. Miratimet për përtëritjen e infrastrukturës janë rritur për dy KRU, për KRU Hidrodrini dhe KRU Mitrovica, për të përmbushur kërkesat minimale për investime, ndërsa pesë të tjerave u janë reduktuar shumatat e kërkuara.

- 3.30 Një analizë më e detajuar e rregullimeve në përtëritjen e infrastrukturës për furnizimin me ujë është dhënë te Shtojca 4 Analiza e rinovimeve të infrastrukturës (ujë).

Investimet e përtëritjes së infrastrukturës për shërbimet e ujërave të ndotura

- 3.31 Për shërbimet e ujërave të ndotura kemi rritur shumë për investime në përtëritje të infrastrukturës gjatë tre viteve të procesit tarifor 2026-2028, nga 3.1 milionë euro në 4.2 milionë euro, për të përmbushur nivelin minimal të investimeve. Për KRU Bifurkacioni, KRU Prishtina dhe KRU Hidroregjioni-Jugor, aplikacionet për përtëritjen e infrastrukturës për ujërat e ndotura nuk janë rregulluar. Për KRU Hidrodrini, KRU Gjakova dhe KRU Mitrovicës iu rritën shumatat në përtëritje të infrastrukturës. Tek KRU Hidromorava investimet e propozuara në përtëritje të infrastrukturës janë zvogëluar pak. Këto rregullime, në përgjithësi, kanë një ndikim të vogël në tarifën e ujërave të ndotura, prej 0.0044 EUR për m³ ujë të shitur.

- 3.32 Një analizë më e detajuar e rregullimeve në përtëritjen e infrastrukturës për ujërat e ndotura është dhënë te Shtojca 5 Analiza e përtëritjes së infrastrukturës (ujërat e ndotura) Shtojca 4 Analiza e rinovimeve të infrastrukturës (ujë).

Investimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës

- 3.33 Investimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës i shtohen BRRRA-së dhe KRU-të fitojnë një kthim real nga BRRRA, 4.25% për Prishtinën dhe 5.25% për gjashtë KRU-të tjera. Për procesin tarifor tre vjeçar 2026-2028, ndikimi në tarifa i investimeve në rritjen/zgjerimin e infrastrukturës është i rreth 6% për Prishtinën dhe 8% për gjashtë KRU-të tjera.⁴
- 3.34 Ndikimi i kategorisë së investimeve në rritjen/zgjerimin të infrastrukturës në tarifa, megjithatë, është i vogël dhe i papërfillshëm. Efekti kumulativ i investimeve në rritjen/zgjerimin të infrastrukturës, siç paraqitet nga KRU-të, shton më pak se 0.0050 EUR për m³ në tarifën e furnizimit me ujë, dhe më pak se 0.0005 EUR për m³ në tarifën e shërbimeve të ujërave të ndotura, deri në vitin 2028.
- 3.35 Rrjedhimisht, ne kemi përcaktuar që propozimet e investimeve për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës duhet të pranohen me rregullime minimale. Nëse KRU-të nuk realizojnë investime në rritjen/zgjerimin e infrastrukturës siç kanë propozuar, efekti i rikthimit brenda tre viteve do të ketë ndikim minimal në tarifën e ardhshme.

Investimet në jo-infrastrukturë

- 3.36 Për investimet jo-infrastrukturore, ndikimi është pak më i madh në atë që përfshin zhvlerësimin sipas kostos aktuale, si dhe kthimin në BRRRA. Ndikimi i investimeve jo-infrastrukturore në tarifa, për procesin tarifor 2026-2028, është rreth 9% për Prishtinën dhe 11% për gjashtë KRU-të tjera.
- 3.37 Ndikimi i kategorisë së investimeve jo-infrastrukturore në tarifa është i vogël, të cilat për furnizimin me ujë është vetëm 0.0097 euro për m³ ujë të furnizuar dhe më pak se 0.0040 euro për m³ për shërbimet e ujërave të ndotura, deri në vitin 2028.
- 3.38 Rrjedhimisht, ne kemi përcaktuar që propozimet e investimeve për investime jo-infrastrukturore duhet të pranohen gjithashtu me rregullime minimale. Nëse KRU-të nuk i realizojnë investimet jo-infrastrukturore, siç janë propozuar, efekti i rikthimit të tyre në procesin e ardhshëm tarifor 2029-2031, do të ketë ndikim minimal në tarifa.

3.6 Rregullime të tjera

- 3.39 Në ndërhyrjet rregullatore ARRU ka bërë edhe disa përmirësime të tjera ku konsideruam se të dhënat e paraqitura ishin ose të pasakta ose jo mjaft sfiduese. Këto ndërhyrje përfshinin ndryshime në tarifën e lidhjes, kërkesat për ujë, tarifën fikse dhe të tjera. Pothuajse në të gjitha rastet ndërhyrjet individuale kishin një ndikim të vogël në tarifa, por kolektivisht ato mund të kishin një ndikim më të rëndësishëm. Këto rregullime quhen 'të tjera' në analizat tona.
- 3.40 ARRU ka bërë gjithashtu disa përshtatje rregullatore në rastet kur të dhënat e paraqitura u vlerësuan si të pasakta ose jo mjaftueshëm sfiduese. Këto përfshinin ndryshime në tarifën e lidhjes, kërkesat për ujë, tarifën fikse dhe elemente të tjera. Secila ndërhyrje individualisht kishte ndikim të vogël në tarifa, por në mënyrë kumulative mund të kishte ndikim më të ndjeshëm.

3.7 Kthimi nga baza rregullatore e aseteve (BRRRA)

- 3.41 Për këtë proces tarifor 2026-2028 kemi aplikuar një kthim real në BRRRA prej 4.25% për KRU Prishtina dhe 5.25% për gjashtë KRU-të e tjera më të vogla. Kjo vijon nga vendimi ynë për procesin tarifor të vitit 2025 ku ne rritëm normën e kthimit në BRRRA, për të gjitha KRU-të, nga niveli i mëparshëm prej 4%.

⁴ Bazuar në një rrjedhë uniforme shpenzimesh gjatë tre viteve që jep një kthim total gjatë tre viteve prej 1.5 x kthim në BRRRA.

- 3.42 Ky kthim nga BRRRA për furnizimin me ujë, mesatarisht është rreth 0.0768 EUR për m³ ujë të shitur në të gjitha KRU-të. Për ujërat e ndotura, kthimi nga BRRRA është rreth 0.0140 euro për m³.
- 3.43 Rritja e normës së kthimit nga BRRRA i ngriti tarifën mesatarisht për 0.0092 EUR dhe 0.0023 EUR për m³ për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura, në të gjitha KRU-të.

3.8 Ndikimi i përgjithshëm i sfidimeve të ARRU në aplikacionet e KRU-ve

- 3.44 Rezultatet e ndërhyrjeve (sfidimeve) të ARRU ndaj aplikacioneve, kanë rezultuar kryesisht në një ulje të tarifave përfundimtare të miratuara. Këto ndërhyrje kryesisht kanë pasur të bëjnë me shpenzimet operative dhe investimet në përtëritjen e infrastrukturës, ku ne i konsideruam aplikacionet si jorealiste. Këto ndërhyrje ilustrohen në [Figura 4](#) dhe Figura 5.

Informacion më i detajuar në lidhje me rregullimet e bëra për KRU individuale jepet në Shtojca 6. Analiza e investimeve kapitale (ujë)

Tabela 6.1 Investimet kapitale të realizuara nga KRU për shërbimet e ujit nga burimet vetjake të financimit

KRU	2022	2023	2024	Totali
FE	83,256	148,354	310,425	542,035
PR	525,526	701,477	762,013	1,989,016
PE	381,219	409,283	1,169,117	1,959,619
PZ	594,062	493,986	691,741	1,779,789
GJI	133,123	170,908	421,796	725,827
GJA	600,850	915,233	666,116	2,182,199
MIT	5,246	79,147	116,999	201,392
Total	2,325,308	2,920,415	4,140,235	9,379,877

Tabela 6.2 Investimeve kapitale për shërbimet e ujit nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	823,000	755,000	850,000	2,428,000
PR	6,715,000	4,715,000	4,345,000	15,775,000
PE	1,038,000	867,000	807,000	2,712,000
PZ	1,101,500	1,236,000	1,405,000	3,742,500
GJI	1,663,600	508,000	2,008,739	4,180,339
GJA	1,396,081	1,542,000	1,930,350	4,868,431
MIT	328,005	420,000	615,000	1,363,005
Total	13,067,212	10,045,027	11,963,117	35,069,275
Miratimet e ARRU-së				
FE	732,035	661,580	614,808	2,008,423
PR	4,701,392	4,028,600	3,641,363	12,371,355
PE	719,676	713,419	738,015	2,171,110
PZ	774,710	813,032	889,812	2,477,554
GJI	534,586	449,290	593,541	1,577,417
GJA	1,214,039	1,160,189	996,374	3,370,602
MIT	828,309	764,303	825,183	2,417,795
Total	9,504,747	8,590,413	8,299,096	26,394,256

Shtojca 7. Analiza e investimeve kapitale (ujëra të ndotur)

Tabela 7.1 Investimet kapitale të realizuara nga KRU për shërbimet e ujërave të ndotura nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2022	2023	2024	Totali
FE	14,461	16,178	5,156	35,794
PR	190,957	44,333	68,848	304,138
PE	13,494	112,348	151,362	277,204
PZ	6,360	1,321	103,396	111,077
GJI	8,797	109,669	53,866	172,332
GJA	2,806	15,264	11,430	29,500
MIT	119	4,710	12,250	17,079
Total	239,016	305,846	408,332	947,124

Tabela 7.2 Investimeve kapitale për shërbimet e ujërave të ndotura nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	70,000	160,000	320,000	550,000
PR	1,435,000	1,150,000	1,150,000	3,735,000
PE	340,000	250,000	260,000	850,000
PZ	530,000	555,000	640,000	1,725,000
GJI	442,000	185,000	150,000	777,000
GJA	0	19,800	601,910	621,710
MIT	0	0	0	0
Total	2,819,026	2,321,827	3,123,938	8,258,710
Miratimet e ARRU-së				
FE	70,000	160,000	320,000	550,000
PR	1,435,000	1,150,000	1,150,000	3,735,000
PE	187,995	234,715	261,333	684,043
PZ	530,000	555,000	640,000	1,725,000
GJI	211,092	167,503	123,729	502,324
GJA	184,322	150,339	280,880	615,541
MIT	192,201	197,901	201,831	591,933
Total	2,810,610	2,615,458	2,977,773	8,403,841

3.45 Shtojca 8 Ndikimi i përgjithshëm tarifor i rregullimeve të ARRU-së (ujë) dhe **Error! Reference source not found.**




Figura 4 – Rregullimet e ARRU në aplikacionet e planeve të biznesit të KRU-ve (ujë)⁵

⁵ "Për çdo vit kolonat në të majtë i referohen rregullimeve të bëra sipas kategorisë së kërkesave të të ardhurave. Kur rregullimi është pozitiv, pra ku kemi rritur lejimin, kjo shfaqet poshtë boshtit. Kolonat në të djathtë tregojnë kërkesën e përgjithshme të paraqitjes si shuma e blusë dhe grisë me grinë që është efekti neto i rregullimeve të ARRU, duke e lënë blunë si të ardhurat përfundimtare të lejuara të përcaktuara."




Figura 5 – Rregullimet në paraqitjet e planit të biznesit (ujërat e ndotura)

4 Përcaktimet rregullatore të procesit tarifor 2026-2028

4.1 Çmimet reale

- 4.1 Të gjitha tarifat (tarifat fikse dhe volumetrike/ variabile) përcaktohen në bazë të çmimit real, të vitit 2025 - niveli i çmimeve të vitit bazë. Tarifat aktuale që do të aplikohen do të përshtaten me inflacion nga viti i kaluar, duke përdorur indekset e çmimeve të konsumit korrik 2024-qershor 2025.

4.2 Tarifat fikse mujore

- 4.2 Tarifat fikse mujore tani bazohen në madhësinë e lidhjes pavarësisht nga kategoria e konsumatorit. Për të gjitha KRU-të tarifat janë të njëjta. Në përcaktimet tona përfundimtare ne kemi vendosur tarifat fikse mujore siç paraqitet në Tabela 1 bazuar në nivelin e çmimeve të mesit të vitit 2025.

Tabela 1 – Tarifat fikse mujore

Madhësia e lidhjes	Njësia	2026	2027	2028
Konsumatorët vetëm me lidhje të ujërave të ndotur	EUR/kons/muaj	0.63	0.63	0.63
15mm	EUR/kons/muaj	1.25	1.25	1.25
20mm	EUR/kons/muaj	1.25	1.25	1.25
25mm	EUR/kons/muaj	2.00	2.00	2.00
32mm	EUR/kons/muaj	2.00	2.00	2.00
40mm	EUR/kons/muaj	8.10	8.10	8.10
50mm	EUR/kons/muaj	8.10	8.10	8.10
65mm	EUR/kons/muaj	20.00	20.00	20.00
80mm	EUR/kons/muaj	20.00	20.00	20.00
100mm	EUR/kons/muaj	24.60	24.60	24.60
125mm	EUR/kons/muaj	24.60	24.60	24.60
150mm	EUR/kons/muaj	38.80	38.80	38.80
200mm	EUR/kons/muaj	38.80	38.80	38.80
250mm	EUR/kons/muaj	54.00	54.00	54.00

4.3 Tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës

- 4.3 Tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës aplikohen për pronat / zhvillimet neto të reja. Përveç tarifave për ekzekutimin e lidhjeve të konsumatorëve, këto tarifa përbëjnë kontribut për investimet infrastrukturore në rrjetin e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, të nevojshme si rezultat i rritjes kumulative afatgjatë të kërkesës për shërbime që rrjedh nga zhvillimet e reja. Kjo siguron që konsumatorët ekzistues të mos bartin kostot e zgjerimit dhe përforcimit të rrjetit të shkaktuara nga këto zhvillime. Tarifat që do të aplikohen nga të gjitha KRU-të për zhvilluesit e pronave janë paraqitur në Tabelën 2, sipas nivelit të çmimeve të mesit të vitit 2025.

Tabela 2 – Tarifat e përforcimit të infrastrukturës

Tarifa e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës	Njësia	2026	2027	2028
Ujë	EUR/lidhje	130.00	130.00	130.00
Ujëra të ndotura	EUR/lidhje	95.00	95.00	95.00

4.4 Tarifat volumetrike

Tarifat volumetrike të përcaktuara për shtatë KRU janë unike brenda zonë së shërbimit të secilës KRU. Tarifat përfundimtare paraqiten në

4.4 Tabela 3, bazuar në nivelin e çmimeve të mesit të vitit 2025.

Tabela 3 – Tarifat për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura (në nivelet e çmimeve të vitit 2025)

KRU	Shërbimi dhe konsumatorët	Njësia	2026	2027	2028
KRU BIFURKACIONI	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.5123	0.5181	0.5187
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.6660	0.6217	0.5706
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1289	0.1450	0.1445
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.2836	0.3190	0.3180
KRU PRISHTINA	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.6082	0.6093	0.6119
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.7907	0.7311	0.6731
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1226	0.1121	0.1078
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.2697	0.2466	0.2371
KRU HIDRODRINI	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.3785	0.3760	0.3723
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.4921	0.4512	0.4095
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1494	0.1533	0.1568
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.2838	0.2607	0.2352
KRU HIDROREJIONI-JUGOR	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.5445	0.5305	0.5228
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.7078	0.6366	0.5751
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1832	0.1971	0.1943
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.4031	0.4337	0.4275
KRU HIDROMORAVA	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.5236	0.5053	0.4925
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.6807	0.6064	0.5417
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1402	0.1613	0.1708
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.3085	0.3548	0.3757
KRU GJAKOVA	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.5002	0.5051	0.5155
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.6503	0.6062	0.5670
	Tarifa e ujit të trajtuar me shumicë	EUR/m ³	0.2200	0.2200	0.2200
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1767	0.1866	0.1894
Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.3887	0.3172	0.2840	
KRU MITROVICA	Furnizimi me ujë				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.5103	0.5115	0.5070
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.6634	0.6138	0.5577
	Shërbimet e ujërave të ndotura				
	Tarifa volumetrike shtëpiak	EUR/m ³	0.1298	0.1286	0.1280
	Tarifa volumetrike jo-shtëpiak	EUR/m ³	0.2856	0.2828	0.2816

4.5 Tarifat e efluenteve tregtare

- 4.5 Gjashtë KRU (KRU Prishtina, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Mitrovica, KRU Gjakova, KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidromorava) kanë kërkuar të përjashtohen nga aplikimi i tarifave për efluentet tregtar. Për procesin tarifor 2026–2028, ARRU ka pranuar këto kërkesa. Megjithatë, duke pasur parasysh se brenda zonës së shërbimit të këtyre KRU-ve ka konsumatorë që gjenerojnë ujëra të ndotura dukshëm më ndotëse se ato të konsumatorëve shtëpiak, aplikimi i tarifave për efluentet tregtare është i arsyeshëm. ARRU do ta shqyrtojë këtë çështje më në detaje në procesin e ardhshëm tarifor dhe mund të rishqyrtojë vendimin aktual, duke kërkuar aplikimin e këtyre tarifave në një ose më shumë KRU. Fillimisht, kjo mund të kufizohet tek konsumatorët e Kategorisë 2 (Tier 2), ku tarifat përcaktohen sipas llojit të aktivitetit ekonomik dhe jo për konsumatorë specifikë të Kategorisë 1 (Tier 1).
- 4.6 KRU Hidrodriini ka tre konsumatorë të mëdhenj që gjenerojnë ujëra të ndotura me nivel të lartë ndotjeje dhe që deri më tani nuk kanë paguar pjesëmarrjen e tyre të drejtë për trajtimin e ujërave të ndotura. Si rezultat, konsumatorët e tjerë në rajonin e Pejës i kanë subvencionuar në mënyrë këto kosto. ARRU ka kërkuar që këta konsumatorë specifikë t'i nënshtrohen tarifave për efluentet tregtare dhe ky vendim është përfshirë në përcaktimin tarifor për KRU Hidrodriini. Këta konsumatorë klasifikohen në kategorinë e konsumatorëve të Nivelit 1 (Tier 1), për të cilët niveli dhe ngarkesa ndotëse përcaktohen në mënyrë specifike. Për shkak të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit tregtar, ARRU nuk publikon të dhëna mbi ngarkesën ndotëse të ujërave të shkarkuara nga këta konsumatorë. Megjithatë, ARRU vlerëson se tarifat e vendosura për ta janë më kosto-reflektive se më parë dhe se konsumatorët e tjerë po paguajnë një çmim më të drejtë për shërbimet e ujërave të ndotura.
- 4.7 Për më tepër, tarifat e përcaktuara për ujërat e ndotura tregtare mund të kenë efektin e dëshiruar duke inkurajuar konsumatorët e prekur të investojnë në impiante të para-trajtimin. Kjo do të rezultonte në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së efluentit të shkarkuar, gjë që është e dobishme për mjedisin dhe mund të çojë në tarifa më të ulëta të aplikuara nga KRU, duke përfituar kështu edhe vetë konsumatorët.

Shtojca 1 Kthimi në BARRA

Skenariot e mëposhtme u dërguan KRU-ve në dhjetor 2024 si pjesë e procesit tarifor njëvjeçar, të vitit 2025. ARRU ka vendosur të vazhdojë me gjetjet e kësaj analize për procesin tarifor 2026-2028.

Skenario A – Përcaktimi i kthimit të bazës rregullatore të asetëve për procesin tarifor të vitit 2025

Historiku

Kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BARRA) është aprovuar të jetë në 4% (reale) për shqyrtimin tarifor 2022 – 2024. E njëjta normë ishte aplikuar edhe në vitin 2021 gjatë një periudhe të një mjedisi me normë shumë të ulët të interesit (afër zero). Që nga viti 2021 normat e interesit dhe inflacioni kanë pësuar rritje të ndjeshme, e mjedisi ekonomik po kthehet në kushtet të ngjashme me periudhën para krizës financiare të vitit 2008. Edhe pse rishikimi për vitin 2025 është vetëm për një vit të vetëm, ne konsiderojmë se një rishikim i kthimit të BARRA mund të jetë i nevojshëm. Pavarësisht lëvizjeve të fundit të normave të interesit, norma "reale" e interesit, pra heqja e efekteve të inflacionit, është në fakt shumë e ulët.

Arsyetimi

ARRU vazhdon të aplikojë 'Modelin e Çmimit të Aseteve Kapitale' (MÇAK) si bazë për përcaktimin e kthimit në BARRA.

MÇAK është përmbledhur në formulën e mëposhtme:

$$\bar{r}_a = r_f + \beta_a(\bar{r}_m - r_f)$$

Ku:

$$\bar{r}_a = \text{expected rate of return for the asset}$$

$$r_f = \text{risk free rate}$$

$$\beta_a = \text{beta of the asset}$$

$$\bar{r}_m = \text{expected market return}$$

Koncepti i MÇAK është se investitorët duhet të kompensohen në një mënyrë që pasqyron rrezikun e biznesit në të cilin po investojnë. Formula e MÇAK është e tillë që investitorët duhet të presin një kthim që përfshin një normë pa rrezik (r_f) plus një prim për të pasqyruar rrezikun e investimit.

Norma pa rrezik (shpesh interpretohet si yield-et afatgjata të obligacioneve të thesarit të vlerësuar AAA (ose gilts), p.sh. obligacionet e emetuara nga bankat qendrore që gëzojnë statusin AAA. r_f)

Primi i rrezikut të tregut është një premium (i përshtatur për të gjitha kapitalet) që investitorët në tregjet e aksioneve presin të marrin në planin afatgjatë për të investuar në aksione. Për të investuar në treg në përgjithësi, investitorët do të presin të marrin një kthim mesatar që reflekton kthimet e pritshme nga tregu në tërësi. Prandaj, 'primi i rrezikut' është $(\bar{r}_m - r_f)$.

Për një aset specifik, rreziku mund të jetë më i madh ose më i vogël se rreziku i tregut. β_a përcaktohet nga aset si shumëzues i primit të rrezikut. Nëse rreziku i një aktivi (i përcaktuar si paqëndrueshmëria e kthimit) është më i madh se rreziku mesatar i tregut, vlera e β_a do të jetë më e madhe se 1.0. Anasjelltas, nëse rreziku është më i vogël se rreziku mesatar i tregut, β_a do të jetë më i vogël se 1.0. Për shembull, kompanitë e kërkimit të naftës me rrezik të lartë mund të kenë një β_a mbi 2.0, ndërsa investimet shumë të sigurta 'blue-chip' si shërbimet e mëdha do të kenë një β_a , të themi, 0.5. Vlera e β_a përcaktohet përmes analizave statistikore afatgjata, nga e cila është e mundur të përcaktohet mesatarisht për sektorë specifikë dhe jo për kompani individuale.

MÇAK në sektorin e ujit në Kosovë

Sektori financiar në Kosovë nuk përfaqëson një strukturë të sofistikuar tregu dhe të dhënat statistikore për primet e rrezikut (për kompani mesatare dhe individuale) nuk janë të disponueshme. Për më tepër, përcaktimi i një norme pa rrezik për Kosovën nuk është gjithashtu i mundur për shkak të adoptimit të euros si monedhë e saj duke mos qenë anëtare e Eurozonës. Megjithatë, është e mundur të përdoren informacione statistikore nga

vendet e tjera për të përdorur një grup zëvendësues parametrash për përcaktimin e normës së kthimit të kapitalit për sektorin e ujit në Kosovë.

Norma e kthimit pa rrezik r_f

Pavarësisht lëvizjeve të fundit të normave të interesit, norma 'reale' e interesit, gjegjësisht duke hequr efektet e inflacionit, është shumë e ulët. Norma aktuale e kthimit pa rrezik e përdorur nga OFWAT (rregullatori i sektorit të ujit për Anglinë dhe Uellsin) për kontrollin e tij më të fundit të çmimeve (RP24) është 0.47% bazuar në një referencë për referencë 20-vjeçare të lidhura me indeks. Një analizë e thjeshtuar e obligacioneve euro sugjeron një normë pa rrezik prej pak më pak se 0.47%.⁶

Në mungesë të ndonjë informacioni të mëtejshëm për Kosovën sugjerohet që mund të aplikohet një normë pa rrezik prej 0.45% (brenda intervalit prej 0.40% deri në 0.50%).

Primi i rrezikut të kapitalit $(\bar{r}_m - r_f)$

Nuk kemi të dhëna për një prim të rrezikut të tregut për Kosovën. Ne e konsiderojmë Malin e Zi të ketë një profil rreziku të ngjashëm si në të njëjtin rajon që përdorë euron si monedhë. Të dhënat aktuale sugjerojnë një prim rreziku prej 11.18%.⁷ Kjo përfshin një prim të rrezikut prej 6.58%. Ne kemi mbajtur qëndrimin se megjithëse ky prim i rrezikut është i rëndësishëm për investitorët e sektorit privat, nuk jemi të bindur se kjo duhet të vlejë plotësisht për sektorin shtetëror të mbështetur nga investimet përmes partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit si KfW dhe agjenci të tjera të ngjashme, të cilat, me funksionin e tyre, mbrojnë huamarrësit e tyre nga rreziku. Ne konsiderojmë se primi i rrezikut mund të reduktohet për KRU-të në Kosovë. Duke ulur primin e rrezikut me 50%, arrijmë në një prim të rrezikut të kapitalit prej 7.89%.

Prandaj, ne kemi aplikuar një prim rreziku prej 8% brenda një intervali prej 7.5% deri në 8.5%.

Beta β_a

Industria e ujit përgjithësisht konsiderohet të jetë një sektor relativisht i sigurt (i izoluar nga konkurrenca agresive dhe duke përfituar nga klientët e kapur dhe rrjedhat e qëndrueshme të të ardhurave). Rrjedhimisht β_a e sektorit është përgjithësisht nën 1.0. OFWAT në MB, në rishikimin e tij më të fundit të çmimeve, aplikoi një gamë aset β_a prej 0.32 deri në 0.34⁸. Hulumtimet në SHBA⁹ sugjerojnë se një β_a prej 0.52 për sektorin e ujit është i përshtatshëm, dhe i njëjti burim sugjeroi një β_a prej 0.42 për sektorin e ujit në Evropë.

Pa asnjë të dhënë specifike për Kosovën, ne sugjerojmë një që në Kosovë të aplikohet një β_a në prej 0.42 për Evropën (me një interval prej 0.40 deri në 0.44).

Primi i rrezikut të kompanive të vogla

Në proceset e kaluara tarifore ne kemi marrë parasysh të njëjtin kthim në BRRRA për të shtatë KRU-të. Skenario B përcakton arsyetimin tonë për dhënien e gjashtë KRU-ve më të vogla një kthim më të lartë në BRRRA sesa për KRU Prishtinë. Ne konsiderojmë se primi i kompanisë së vogël ndaj kthimit të BRRRA duhet të jetë 1.00%.

Rregullimi në kthimin para tatimor

Korniza MÇAK bazohet në një kthim në kapital pas taksave. Modeli tarifor, megjithatë, bazohet në një kthim para tatimit të kapitalit dhe nevojitet një rregullim. Në bazë të faktit se KRU-të në Kosovë nuk kanë nivele materiale të borxhit dhe se tarifat e interesit, nëse ka, janë të papërfillshme, mund të supozohet se këto deklarata do t'i nënshtrohen tatimit me normën e tatimit mbi korporatat prej 10%. Rrjedhimisht, për të arritur në një kthim para tatimit mbi kapitalin kërkohet një rregullim prej 1/(1-10%).

⁶ <https://markets.ft.com/data/bonds/government-bonds-spreads> Në kohën e duhur, yield-i i obligacioneve qeveritare 10-vjeçare të Eurozonës varion nga 2.47% (Gjermani) dhe 3.87% (Itali). Për pa rrezik nominal ne supozojmë skajin e poshtëm të këtij intervali. Së bashku me inflacionin aktual prej 2.4% dhe objektivin afatgjatë të inflacionit të BQE-së prej 2%, kjo është e baBRRRAartë me një normë reale pak më të ulët se 0.47%, që rastësisht korrespondon me përcaktimin e Ofwat të një norme pa rrezik.

⁷ https://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/datafile/ctryprem.html

⁸ https://www.ofwat.gov.uk/wp-content/uploads/2022/12/PR24_final_methodology_Appendix_11_Allowed_return.pdf

⁹ http://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/datafile/Betas.html

Kthimi i llogaritur në BRR

Bazuar në supozimet e mësipërme, vlerësimet e mëposhtme të kthimit nga BRR ilustrohen në tabelat e mëposhtme.

KRU Prishtina	Rekomandohet	Min	Maks
Norma e kthimit pa rrezik r	0.45%	0.40%	0.50%
Asetet beta β_a	0.42	0.40	0.44
Primi i rrezikut të kapitalit $(\bar{r}_m - r_f)$	8.00%	7.50%	8.50%
Kthimi pas tatimit mbi kapitalin (real)	3.81%	3.40%	4.24%
Kthimi para tatimit mbi kapitalin (real)	4.23%	3.78%	4.71%

Gjashtë KRU-të e vogla	Rekomandohet	Min	Maks
Norma e kthimit pa rrezik r	0.45%	0.40%	0.50%
Asetet beta β_a	0.42	0.40	0.44
Primi i rrezikut të kapitalit $(\bar{r}_m - r_f)$	8.00%	7.50%	8.50%
Kthimi pas tatimit mbi kapitalin (real)	3.81%	3.40%	4.24%
Primi i rrezikut të kompanive të vogla	0.95%	0.80%	1.10%
Kthimi pas tatimit mbi kapitalin (real)	4.76%	4.20%	5.34%
Kthimi para tatimit mbi kapitalin (real)	5.29%	4.67%	5.93%

Konkluzionet dhe rekomandimet

Duke pasur parasysh të dhënat e përditësuara mbi kthimet aktuale të tregut, ARRU sugjeron që kthimi aktual prej 4% në BRR nuk ishte i përshtatshëm për t'u aplikuar në procesin tarifor 2025. ARRU ka propozuar kthimi për 2025 të rritet në një normë reale prej 4.25% për Prishtinën. Për ta vënë këtë në kontekst, ky 0.25% shtesë është i barabartë me një rritje të të ardhurave prej rreth 180,000 euro në vit për KRU Prishtina.

Për gjashtë KRU-të tjera ne konsideruam se ato duhet t'i nënshtroheshin një kthimi në BRR që përfshin një prim të rrezikut të kompanisë së vogël dhe se kthimi total i BRR për to të rritet në 5.25%. Kjo rezulton në një rritje totale shtesë të të ardhurave prej rreth 750,000 euro në të gjashtë KRU-të më të vogla.

Skenari B – Primi i rrezikut për kompanitë e vogla

Burimi i hulumtimit

Ekziston një numër i konsiderueshëm i hulumtimeve të bazuara në prova të përforcuara nga precedentet rregullator për të mbështetur rastin se kompanitë e vogla, të rregulluara kërkojnë një kosto më të lartë të kapitalit, si kapital ashtu edhe borxh, sesa kompanitë më të mëdha. London Economics, 2010 (në tekstin e mëtejshëm referuar si raporti LE) ofron një përmbledhje të detajuar të hulumtimeve të gjera dhe rezultateve të sfidave me të cilat përballen kompanitë e vogla në lidhje me financimin e tyre¹⁰.

Kostoja e primeve të kompanive të vogla të kapitalit

Raporti LE (Përmbledhje Ekzekutive) vlerëson që primi i kapitalit të kompanive të vogla të jetë 0.80% deri në 2.63% mbi MÇAK beta herë primin e rrezikut të kapitalit të tregut. Raporti LE citon shumë arsye për këtë ngritje, duke përfshirë:

- dëshmitë akademike dhe modelimi i kthimeve të kompanive të vogla;
- rritja e rreziqeve me të cilat përballen kompanitë e vogla ku ato duhet të demonstrojnë rritje për të tërhequr financa;

¹⁰ London Economics, *Kostoja e Kapitalit të Biznesit të Vogël*, 2010, <https://londoneconomics.co.uk/blog/publication/small-business-cost-of-capital-2/>

- rreziqe të tjera duke përfshirë rritjen e ndryshueshmërisë së kostove operacionale kundrejt shpenzimeve kapitale me të cilat mund të përballen kompanitë më të vogla;
- Një premium i kompanisë së vogël mund të jetë gjithashtu një funksion i tregtimit jolikuid; dhe
- kompanitë më të vogla posedojnë më pak forma të kolateralit të pranueshëm.

Ky fenomen është njohur nga rregullatorët në Mbretërinë e Bashkuar dhe gjetkë:

- Ofwat (rregullatori i industrisë së ujit në Mbretërinë e Bashkuar), pas një apeli të suksesshëm nga Bristol Water në Komisionin e Konkurrencës, parashikon një sërë të kostos së kapitalit sipas shkallës së madhësisë (të matura me vlerën e asetëve të kapitalit rregullator);
- CREG (rregullatori belg i energjisë) lejoi një shumëzues 'likuiditeti' i cili barazohet me një rritje prej 0.7% deri në 1.0%; dhe
- Ofgem (MB) ka lejuar një premium prej 0.8% për koston e kapitalit për sektorin e vogël të transportuesve të pavarur të gazit (IGT).

Raporti LE citon një analizë nga Duff & Phelps ku vlerësohet marrëdhënia midis madhësisë dhe primit dhe sugjeron se një rritje prej 10% në vlerën mesatare të tregut të kapitalit rezulton në një ulje prej 0.22% të primit mbi MÇAK. Kjo sugjeron se në rastin e KRU-ve më të vogla, me një BRRRA mesatare prej rreth 15% të asaj të KRU Prishtinës, një prim prej 1.9% mbi MÇAK beta herë primin e rrezikut të kapitalit të tregut.

Kostoja e primeve të borxhit të kompanive të vogla

Sa i përket koston së kapitalit, kompanitë e vogla kanë kosto më të larta borxhi në krahasim me kompanitë më të mëdha. Hulumtimi i cituar në Raportin LE sugjeron se primi mesatar i borxhit për kompanitë e vogla është 2.48%. Kjo përfshin tarifën më të larta të transaksionit në krahasim me financimin me të cilin përballen kompanitë e vogla.

Ekziston precedent rregullator për këtë, p.sh. primi 1.60% i Ofwat pas apelit të Bristol Water, primi 2.00% deri në 3.00% i Ofgem për sektorin e transportuesve të pavarur të gazit (IGT) dhe një 1.00% deri në 1.80% për kontrollin e çmimit të shpërndarjes (2004). Raporti i LE arrin në përfundimin se për sektorin IGT në MB primi i borxhit duhet të jetë në intervalin 2.70% deri në 3.60%.

Në përgjithësi, ne konsiderojmë se një prim i lejuar mbi koston e borxhit për KRU-të më të vogla do të reflektonte koston shtesë të borxhit që ka të ngjarë të shkaktohen nëse ato do të angazhoheshin në huamarrje për investime. Aktualisht niveli i borxhit të këtyre kompanive është shumë i vogël dhe një prim borxhi nuk merret parasysh për këtë rishikim tarifor njëvjeçar. Ne do të monitorojmë strukturën e kapitalit të KRU-ve dhe nëse strukturat e tyre të kapitalit ndryshojnë, ne do të marrim parasysh primin e kompanive të vogla për borxhin në përcaktimin tonë të kthimit nga BRRRA në të ardhmen.

Primi i kompanive të vogla për KRU-të në Kosovë

Pozicioni i KRU-ve si ndërmarrje publike vendos një pikëpyetje mbi vlefshmërinë e aplikimit të plotë të primit të kompanive të vogla. Ne konsiderojmë se për rishikimi njëvjeçar të aplikojmë gjysmën e primit të kapitalit prej 1.9% të përcaktuar nga analiza Duff & Phelps, pra 0.95% brenda një intervali prej 0.8% dhe 1.1%. Ne do ta shqyrtojmë këtë aspekt më në detaje për rishikimin e tarifave 2026-2028.

Shtojca 2 Udhëzimet për tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës

Objektivat e politikave

Dokumenti aktual i *Politikave të Ujit të Qeverisë (2015)*, përgatitur nga Këshilli Ndërmintor i Ujit (KNMU) thotë:

Deklarata e politikave: Tarifa e zhvillimit të infrastrukturës

Qeveria u bën thirrje komunave, në bashkëpunim me ARRU dhe KRU, të marrin në konsideratë aplikimin dhe mbledhjen e një tarife për zhvillimin e infrastrukturës ujore përveç tarifës së zhvillimit të infrastrukturës komunale (për rrugët, kullimin, ndriçimin e rrugëve etj.). Tarifa e zhvillimit të infrastrukturës së ujit do të duhet të jetë një tarifë e rregulluar që i nënshtrohet miratimit të ARRU.

Këto udhëzime janë në përputhje me këtë objektiv të politikës.

Sfondi dhe nevoja për tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës

Vitet e fundit ka pasur zhvillime të reja banesore dhe komerciale në Kosovë që po e sforcjnë rrjetin e KRU-ve për të ofruar shërbime të ujësjes dhe kanalizimit në harmoni me nivelin e kërkuar të shërbimit. Aktualisht, zhvilluesit/investitorët mbulojnë koston e rrjetet terciar të ujësjes dhe kanalizimit brenda kufijve të pronës së ndërtimit, dhe këto asete më pas miratohen nga KRU¹¹. Me kalimin e kohës, efektet kumulative të zhvillimeve të shumta do të kërkojnë përforcimin e aseteve të rrjetit të ujit (në pjesën e sipërme të prurjeve) dhe të kanalizimit në pjesën poshtë shkarkimeve. Kjo ilustron në Figura 66.




Figura 6 – Zhvillimi i ri që imponon investime për përforcimin e rrjetit jashtë vendit

Në kuadër të procesit aktual të përcaktimit të tarifave, kjo mbingarkesë e rrjetit financohet nga të gjithë konsumatorët ekzistues si përmirësim i infrastrukturës dhe përfshihet në tarifën për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura. Ne konsiderojmë se kjo nuk është kosto reflektive dhe se një sforcim i tillë duhet të paguhet nga zhvilluesit që shkaktuan nevojën e mbingarkesës. Kjo është në përputhje me tarifën e

¹¹ Infrastruktura terciare zakonisht ndërtohet nga zhvilluesit dhe u dorëzohet KRU-ve pas përfundimit. Në disa raste, komunat mund të zhvillojnë infrastrukturën terciare të ujit dhe ujërave të ndotura ose t'u bëjnë thirrje KRU-ve për ta siguruar atë. Këto kosto më pas i kalojnë zhvilluesit. Zhvilluesi rikuperon investimin në infrastrukturën terciare përmes shitjes ose marrjes me qira të pronave brenda zhvillimit. KRU do të aplikojë një tarifë lidhjeje për çdo pronë individuale për të mbuluar koston e tubave të shërbimit, matësve dhe aparateve të tjera të nevojshme specifike për konsumatorët individualë plus një shumë për të përballuar koston administrative përkatëse.

infrastrukturës siç aplikohen nga rregullatorët në shtetet tjera në botë. Këto udhëzime përcaktojnë një proces për vendosjen e tarifave për zhvilluesit si kontributi i tyre në kostot afatgjata të përforcimit të infrastrukturës.

Karakteristikat e aktiviteteve zhvillimore dhe ndikimet e tyre në rrjet

Ka shumë aktivitete që mund të kontribuojnë në rritjen e kërkesës për ujë dhe prodhimin e ujërave të ndotura. Disa do të kontribuojnë në nevojën për përforcim të rrjetit, dhe disa jo (shih Tabela 4).

Tabela 4 – Llojet e aktivitetit të zhvillimit dhe ndikimi i tyre në nevojat e përforcimit të rrjetit

Lloji i zhvillimit ose aktivitetit	Kontributi në përforcimin e rrjetit	Komente
Zhvillime të reja rezidenciale ose komerciale ku nuk kishte më parë që rezultojnë në rritje të kërkesës dhe flukseve të ujërave të ndotura.	Po	Nëse një vend zhvillohet aty ku nuk ka pasur zhvillim më parë, atëherë zhvillimi do të kontribuojë në nevojën për përforcim të rrjetit.
Zhvillimet e reja (shtëpiake dhe joshtëpiake) në zonat ekzistuese të zhvilluara, por mund të mos kontribuojnë domosdoshmërisht në rritjen e kërkesës dhe flukseve të ujërave të ndotura.	Ndonjëherë	Kontributi në përforcimin e rrjetit bazohet në rritjen neto të kërkesës. Për shembull, nëse një bllok banimi ekzistues i përbërë nga 15 banesa prishet dhe zëvendësohet me një bllok prej 25 banesash, kontributi neto në rritjen e kërkesës dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura është nga rritja neto e numrit të banesave, pra 10 banesa.
Pronat ekzistuese nuk janë të lidhura me sistemin, por me zgjerimin e sistemit ato mund të lidhen (kjo vlen kryesisht për ujërat e ndotura dhe jo për furnizimin me ujë)	Po	Lidhja me sistemin do të kontribuojë në rritjen e kërkesës ose rrjedhave të ujërave të ndotura dhe për këtë arsye do të kontribuojë në nevojën për përforcim të rrjetit.
Miratimi i zonave shtesë të shërbimit dhe sistemeve shoqëruese të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura në pronësi të kompanive rajonale të ujësjellësit (KRU)	Jo	Nëse sistemi i ri miratohet, supozohet se rrjetet janë tashmë të përshtatshme për konsumatorët ekzistues. Çdo konsumator i ri i shtuar më pas në këto sisteme do të kontribuojë në nevojën për përforcim të rrjetit.

Kontributi në nevojat e përforcimit të rrjetit përcaktohet nga numri i pronave të reja neto dhe jo nga totali i pronave të reja. Zëvendësimi i një blloku ekzistues apartamentesh prej 15 banesash me një objekt me 25 banesa, do të rezultojë me 10 banesa të reja neto.

Nëse një bllok ekzistues prej 25 banesash zëvendësohet me një bllok prej 15 banesash, kërkesa zvogëlohet, por kjo nuk do të rezultojë në një zvogëlim të diametrit të gypave të ujit apo kanalizimit. Rrjedhimisht, një reduktim i kërkesës nuk do të gjenerojë tarifa negative.

Përcaktimi i një tarife të përshtatshme të mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës

Tarifa e konsumatorëve shtëpiak

Në teori, tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës, me kalimin e kohës, duhet të përputhen me investimet afatgjata në përmirësimin e infrastrukturës për të përmbushur ekuilibrin mes kërkesës dhe ofertës. Kjo është një llogaritje pothuajse e pamundur pa shumë vite të dhëna që mund të analizohen për të përcaktuar një tarifë të përshtatshme për banesë. Qasja jonë është të përcaktojmë një tarifë të përshtatshme që bazohet në një vlerësim të BRRRA fillestare të vitit 2008 siç përcaktohet në llogaritjen e mëposhtme.

Kutia 1 – Përcaktimi i tarifës së mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës

Kur u përcaktua BRRRA fillestare (2008) u kalkulua me 200 euro për lidhje për ujë dhe 100 euro për ujërat e ndotura. Në nivelet e çmimeve të vitit 2024 këto vlera janë përkatësisht 297 euro dhe 148 euro. Nëse konsumatorët jo-shtëpiakë konvertohen në numra ekuivalentë shtëpiakë proporcional me normat e fluksit, vlerat e hapjes ekuivalente shtëpiak do të

jenë më të ulëta. Analiza jonë e të dhënave të konsumit sugjeron se këto vlera duhet të rregullohen përkatësisht në 268 euro dhe 134 euro për ujësjellësin dhe ujërat e ndotura për një pronë tipike shtëpiake.

Në vitin 2008 asetet e rrjetit të ujësjellësit përbënin rreth 70% të totalit të aseteve. Prandaj, një BRRRA hapëse për asetet e infrastrukturës ujore për një pronë shtëpiake (nivelet e çmimeve 2024) do të ishte:

(1) BRRRA fillestare e infrastrukturës së ujit (nivelet e çmimeve 2024) = $0.7 \times 268 \text{ EUR} = 188 \text{ EUR}$ për ekuivalent shtëpiak

Për ujërat e ndotura kishte shumë pak asete që lidheshin me trajtimin kur u krijua BRRRA fillestare. Prandaj, asetet e infrastrukturës së ujërave të ndotura për një pronë shtëpiake (në nivelet e çmimeve të vitit 2024) do të ishin:

(2) BRRRA fillestare e infrastrukturës së ujit (nivelet e çmimeve 2024) = $1.0 \times 134 \text{ EUR} = 134 \text{ EUR}$ për ekuivalent shtëpiak

Këto vlera lidhen me të gjitha asetet e infrastrukturës së rrjetit, duke përfshirë rrjetet terciare, të cilat një zhvillues do t'i financonte drejtpërdrejt. Është pothuajse e pamundur të ndahen vlerat BRRRA për rrjetin primar dhe terciar, kështu që një supozim i thjeshtë arbitrar është i nevojshëm, p.sh. supozoni se rrjetet terciare përbëjnë 30% të vlerave totale të rrjetit.

Prandaj, BRRRA fillestare (nivelet e çmimeve 2024) për rrjetet jo-terciare do të ishte në rendin e:

(3) Rrjeti jo-terciar i infrastrukturës ujore BRRRA = $0.7 \times 188 \text{ EUR} = 131 \text{ EUR}$ për ekuivalent shtëpiak, dhe

(4) Rrjeti jo-terciar i infrastrukturës së ujërave të ndotura BRRRA = $0.7 \times 134 \text{ EUR} = 94 \text{ EUR}$ për ekuivalent shtëpiak.

Prandaj propozohen tarifa për mbingarkesë (përforcim) të infrastrukturës për furnizimin me ujë prej 130 euro për konsumatorë dhe tarifa për mbingarkesë (përforcim) të infrastrukturës për ujërat e ndotura prej 95 euro për konsumatorë. ARRU propozon që këto tarifa t'i nënshtrohen përshtatjeve vjetore të inflacionit në përputhje me procesin e përcaktimit të tarifave.

Tarifa joshtëpiake

Lidhjet joshtëpiake mund të ndryshojnë në madhësi nga një dyqan i vogël në një fabrikë të madhe. Rrjedhimisht, tarifat e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës duhet të përcaktohen në bazë të situatës specifike. Qasja më e thjeshtë është konvertimi i konsumatorit jo-shtëpiak në një ekuivalent shtëpiak bazuar në konsumin e parashikuar të ujit dhe të dhënat e prodhimit të ujërave të ndotura. Nga të dhënat e raportimit t'për treguesit e performancës rrjedh se konsumi mesatar i ujit është 11.14 m^3 në muaj ose 134 m^3 në vit për konsumatorët shtëpiak. Rrjedhimisht, nëse një konsumatorë i ri jo-shtëpiak e konfirmon një kërkesë të parashikuar për ujë prej $1,000 \text{ m}^3$ në vit dhe pjesa më e madhe e këtij uji do të hyjë përfundimisht në rrjetin e ujërave të ndotura, do të konsiderohet ekuivalente me $1000/134 = 7.5$ konsumatorë shtëpiak.

Për thjeshtësi, ne rekomandojmë që ekuivalenti shtëpiak të rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt. Në shembullin e mësipërm, pra tarifa e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës do të ishte $7 \times (130 \text{ EUR} + 95 \text{ EUR}) = 1,575.00 \text{ EUR}$.

Në përcaktimin e tarifave të rrjetit për konsumatorët jo-shtëpiakë duhet të merren parasysh variacionet sezonale. Është kërkesa maksimale që do të përcaktojë nevojën për përforcim të rrjetit. Në shembullin e mësipërm kërkesa mesatare mujore është $1,000/12 = 83 \text{ m}^3$ në muaj ($7.5 \times$ mesatarja). Por nëse kërkesa maksimale sezonale do të ishte $1.5 \times$ mesatarja, pra 124 m^3 në muaj, në muajt e pikut të kërkesës, atëherë konsumatori jo-shtëpiak do të konsiderohej si ekuivalent me $124/12 = 11$ konsumatorë shtëpiake për qëllime të përcaktimit të tarifës së mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës. Në këtë shembull, tarifa do të ishte $2,475.00 \text{ EUR}$.

Për lidhjet e vogla jo-shtëpiake, tarifa nuk duhet të jetë më e vogël se ajo që aplikohet për një banesë të vetme.

Për lidhjet më të mëdha të reja joshtëpiake, tarifa mund të ketë efektin e inkurajimit të masave të kursimit të ujit për të zvogëluar kërkesën e parashikuar dhe kështu për të ulur tarifën.

Pronarët e lidhjeve të reja jo-shtëpiake do të kenë një nxitje për të nën-raportuar parashikimet e kërkesës për të ulur tarifat. Ne konsiderojmë se do të ishte e përshtatshme që KRU të monitoronte konsumin (mesatar dhe

në kohën e pikut) dhe, pas një periudhe të arsyeshme (të paktën një vit), të rivlerësonte tarifën bazuar në konsumin aktual dhe të rikuperonte çdo mungesë. Ne gjithashtu sugjerojmë që çdo mungesë t'i nënshtrohet një tarife shtesë prej 50% për të inkurajuar konsumatorin jo-shtëpiak të paraqesë parashikime realiste në radhë të parë. Asnjë rivlerësim nuk duhet të bëhet më shumë se tre vjet pas lidhjes.

Nëse rivlerësimi përcakton se konsumi është më i vogël se sa parashikohet, nuk do të ketë rimbursim të tarifave.

Aplikimi i tarifave dhe trajtimi rregullator

KRU-të do të këshillojnë zhvilluesit për tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës që do të zbatohen për zhvillimin e tyre. KRU-të do të përcaktojnë se si faturojnë dhe mbledhin tarifën. Nga një këndvështrim rregullator ne do të supozojmë se tarifën mblidhen në vitin që lidhjet e reja bëhen realizohen.

Tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës do të trajtohen si një kontribut i klientit për përmirësimin e infrastrukturës për ekuilibrin ofertë/kërkesë. Kjo do të thotë që të ardhurat nga tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës do të trajtohen si financim granti dhe si të tilla do të zvogëlojnë shumën që shton BRRR-në dhe kështu do të ulin tarifën. Për shembull, nëse shpenzimet për rritje/zgjerimin e infrastrukturës janë 1 milion EUR, por 0.6 milion EUR merren nga tarifën e mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës, atëherë BRRR do të rritet me vetëm 0.4 milion EUR. Duke supozuar një kthim prej 4% nga BRRR, kërkesa për të ardhura do të bjerë nga 40,000 euro nëse nuk ka tarifë në 16,000 euro me tarifën, me uljen që do t'u kalojë konsumatorëve si ulje të tarifave. Kjo veçori do të përfshihet në modelin e përcaktimit të tarifave.

Ne vlerësojmë se projeksioni i lidhjeve të shtuara i nënshtrohet një shkalle pasigurie. Prandaj, ne konsiderojmë se në fund të kontrollit trevjeçar të rishikimit të tarifave duhet të zbatohet një rakordim i të ardhurave të parashikuara dhe aktuale të tarifave të mbingarkesës (përforcimit) të infrastrukturës dhe ndryshimet të pasqyruara në tarifën për rishikimin pasues trevjeçar të tarifave. Kjo veçori do të përfshihet në modelin e përcaktimit të tarifave.

Shtojca 3: Analiza e kostove operative, uji dhe ujërat e ndotura

Tabela 3.1 Shpenzimet operative pa përfshirë koston e energjisë elektrike – UJË

Aplikimi nga KRU					
KRU	2024	2025	2026	2027	2028
FE	1,634,199	1,795,668	2,065,614	2,125,398	2,175,452
PR	8,462,725	9,411,657	10,221,782	11,120,167	12,050,511
PE	2,855,919	2,239,965	2,712,530	2,861,746	3,019,782
PZ	2,932,768	3,396,750	4,002,665	4,221,311	4,333,082
GJI	1,629,961	1,862,814	2,197,601	2,303,113	2,364,380
GJA	3,220,396	3,673,156	3,972,600	4,301,989	4,664,316
MIT	3,030,815	3,308,469	4,563,452	4,791,624	4,797,504
Total	23,766,782	25,688,479	29,736,243	31,725,348	33,405,027
Miratimi i ARRU-së					
FE			1,873,790	1,916,071	1,949,885
PR			9,189,368	9,420,067	9,600,757
PE			2,448,958	2,476,139	2,506,038
PZ			2,686,666	2,871,512	2,954,587
GJI			1,929,589	2,018,298	2,119,689
GJA			3,464,174	3,751,989	4,064,316
MIT			3,470,444	3,523,661	3,551,599
Total			25,062,989	25,977,737	26,746,871
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare					
FE			-191,823	-209,326	-225,567
PR			-1,032,414	-1,700,100	-2,449,754
PE			-263,571	-385,607	-513,745
PZ			-1,315,999	-1,349,799	-1,378,495
GJI			-268,012	-284,815	-244,691
GJA			-508,426	-550,000	-600,000
MIT			-1,093,007	-1,267,963	-1,245,905
Total			-4,673,253	-5,747,611	-6,658,156
Sfidimi nga ARRU në përqindje					
FE			-9.3%	-9.8%	-10.4%
PR			-10.1%	-15.3%	-20.3%
PE			-9.7%	-13.5%	-17.0%
PZ			-32.9%	-32.0%	-31.8%
GJI			-12.2%	-12.4%	-10.3%
GJA			-12.8%	-12.8%	-12.9%
MIT			-24.0%	-26.5%	-26.0%
Total			-15.7%	-18.1%	-19.9%

Tabela 3.2 Shpenzimet e energjisë elektrike - UJË

Aplikimi nga KRU					
KRU	2024	2025	2026	2027	2028
FE	218,182	500,745	718,461	729,238	736,530
PR	2,312,708	4,669,571	6,363,737	6,681,924	7,016,020
PE	611,133	923,788	1,609,795	1,770,775	1,947,852
PZ	954,669	1,955,900	2,635,191	2,698,651	2,809,935
GJI	260,405	617,319	986,614	1,006,826	1,027,069
GJA	342,353	643,945	652,000	662,500	673,000
MIT	809,161	1,804,609	3,277,560	3,441,438	3,527,474
Total	5,508,611	11,115,877	16,243,358	16,991,352	17,737,881
Miratimet e ARRU-së					
FE			649,053	653,542	657,259
PR			6,536,194	6,325,495	6,277,352
PE			1,725,673	1,739,884	1,755,400
PZ			2,857,007	2,839,727	2,852,018
GJI			740,486	752,691	782,645
GJA			456,246	456,746	457,246
MIT			2,962,884	2,964,624	2,965,538
Total			15,927,542	15,732,709	15,747,459
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare					
FE			-69,408	-75,696	-79,271
PR			172,457	-356,429	-738,668
PE			115,879	-30,891	-192,452
PZ			221,816	141,076	42,083
GJI			-246,128	-254,135	-244,424
GJA			-195,754	-205,754	-215,754
MIT			-314,676	-476,814	-561,936
Total			-315,816	-1,258,643	-1,990,422
Sfidimi nga ARRU në përqindje					
FE			-9.7%	-10.4%	-10.8%
PR			2.7%	-5.3%	-10.5%
PE			7.2%	-1.7%	-9.9%
PZ			8.4%	5.2%	1.5%
GJI			-24.9%	-25.2%	-23.8%
GJA			-30.0%	-31.1%	-32.1%
MIT			-9.6%	-13.9%	-15.9%
Total			-1.9%	-7.4%	-11.2%

Tabela 3.3 Shpenzimet operative pa përfshirë koston e energjisë elektrike – UJËRA TË NDOTURA

Aplikimi nga KRU					
KRU	2024	2025	2026	2027	2028
FE	358,357	388,530	451,341	477,311	501,284
PR	2,178,357	2,457,402	3,281,123	3,034,659	3,178,314
PE	324,112	895,816	1,094,269	1,157,243	1,224,194
PZ	1,040,797	1,104,603	1,314,895	1,398,531	1,468,457
GJI	178,075	202,645	377,730	448,459	652,958
GJA	320,769	346,503	375,766	407,957	443,366
MIT	394,549	446,390	657,276	690,140	697,414
Total	4,795,016	5,841,889	7,552,400	7,614,301	8,165,986
Miratimet e ARRU-së					
FE			408,088	419,509	429,848
PR			2,475,887	2,348,128	2,241,626
PE			1,116,742	1,142,055	1,167,064
PZ			1,390,174	1,461,409	1,478,239
GJI			351,198	368,009	482,074
GJA			884,192	957,957	973,366
MIT			1,012,697	1,045,561	1,052,268
Total			7,638,978	7,742,628	7,824,486
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare					
FE			-43,253	-57,802	-71,436
PR			-805,236	-686,531	-936,688
PE			22,473	-15,188	-57,130
PZ			75,279	62,879	9,782
GJI			-26,531	-80,451	-170,883
GJA			508,426	550,000	530,000
MIT			355,421	355,421	354,855
Total			86,579	128,327	-341,500
Sfidimi nga ARRU në përqindje					
FE			-9.6%	-12.1%	-14.3%
PR			-24.5%	-22.6%	-29.5%
PE			2.1%	-1.3%	-4.7%
PZ			5.7%	4.5%	0.7%
GJI			-7.0%	-17.9%	-26.2%
GJA			135.3%	134.8%	119.5%
MIT			54.1%	51.5%	50.9%
Total			1.1%	1.7%	-4.2%

Tabela 3.4 Shpenzimet e energjisë elektrike – UJËRA TË NDOTURA

Aplikimi nga KRU					
KRU	2024	2025	2026	2027	2028
FE	2,137	4,973	7,036	7,142	7,213
PR	272,232	565,255	770,335	808,852	849,294
PE	61,113	109,150	190,205	209,224	230,147
PZ	87,109	112,420	156,899	228,053	239,455
GJI	265	630	81,008	217,028	277,050
GJA	99,627	161,092	122,600	122,800	123,000
MIT	20,353	45,391	82,440	86,562	88,726
Total	542,836	998,911	1,410,523	1,679,661	1,814,885
Miratimet e ARRU-së					
FE			6,095	6,208	6,299
PR			809,932	837,713	866,611
PE			203,734	205,534	207,485
PZ			171,014	235,165	242,941
GJI			80,703	216,742	216,782
GJA			285,813	285,813	285,813
MIT			127,019	131,141	133,871
Total			1,684,311	1,918,315	1,959,801
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare					
FE			-941	-933	-914
PR			39,597	28,861	17,317
PE			13,529	-3,690	-22,662
PZ			14,115	7,112	3,486
GJI			-305	-286	-60,268
GJA			163,213	163,013	162,813
MIT			44,579	44,579	45,145
Total			273,788	238,654	144,916
Sfidimi nga ARRU në përqindje					
FE			-13.4%	-13.1%	-12.7%
PR			5.1%	3.6%	2.0%
PE			7.1%	-1.8%	-9.8%
PZ			9.0%	3.1%	1.5%
GJI			-0.4%	-0.1%	-21.8%
GJA			133.1%	132.7%	132.4%
MIT			54.1%	51.5%	50.9%
Total			19.4%	14.2%	8.0%

Shtojca 4 Analiza e rinovimeve të infrastrukturës (ujë)

Tabela 4.1 Investimet e realizuara në përtëritjen e infrastrukturës për vitet 2022-2024

KRU	2022	2023	2024
FE	5,150	30,729	22,651
PR	9,206	7,672	5,797
PE	83,858	118,878	508,618
PZ	276,808	112,987	146,177
GJI	2,755	0	150,984
GJA	216,936	506,043	452,314
MIT	0	0	0
Total	594,713	776,309	1,286,541

Tabela 4.2 Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për vitet 2026-2028

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	255,000	560,000	570,000	1,385,000
PR	2,890,000	1,735,000	1,825,000	6,450,000
PE	252,500	274,500	269,500	796,500
PZ	690,750	789,500	884,000	2,364,250
GJI	499,900	285,500	1,238,550	2,023,950
GJA	696,770	619,900	1,228,680	2,545,350
MIT	0	380,000	315,000	695,000
Total	5,284,920	4,644,400	6,330,730	16,260,050
Miratimet e ARRU-së				
FE	324,035	333,580	334,808	992,423
PR	876,392	1,048,600	1,121,363	3,046,355
PE	334,176	370,919	400,515	1,105,610
PZ	363,960	366,532	368,812	1,099,304
GJI	246,889	226,790	238,665	712,344
GJA	514,728	388,089	294,704	1,197,520
MIT	500,304	524,303	525,183	1,549,790
Total	3,160,483	3,258,813	3,284,050	9,703,345
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare				
FE	69,035	-226,420	-235,192	-392,577
PR	-2,013,608	-686,400	-703,637	-3,403,645
PE	81,676	96,419	131,015	309,110
PZ	-326,790	-422,968	-515,188	-1,264,946
GJI	-253,011	-58,710	-999,885	-1,311,606
GJA	-182,042	-231,811	-933,976	-1,347,830
MIT	500,304	144,303	210,183	854,790
Total	-2,124,437	-1,385,587	-3,046,680	-6,556,705
Sfidimi nga ARRU në përqindje				
FE	27%	-40%	-41%	-28%
PR	-70%	-40%	-39%	-53%
PE	32%	35%	49%	39%
PZ	-47%	-54%	-58%	-54%
GJI	-51%	-21%	-81%	-65%
GJA	-26%	-37%	-76%	-53%
MIT	NA	38%	67%	123%
Total	-40%	-30%	-48%	-40%

Shtojca 5 Analiza e përtëritjes së infrastrukturës (ujërat e ndotura)

Tabela 5.1 Investimet e realizuara në përtëritjen e infrastrukturës për vitet 2022-2024

KRU	2022	2023	2024
FE	62,651	76,881	32,038
PR	235,966	0	0
PE	5,463	0	17,564
PZ	5,322	0	0
GJI	0	0	0
GJA	0	0	0
MIT	0	0	0
Total	309,401	76,881	49,602

Tabela 5.2 Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për vitet 2026-2028

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	50,000	130,000	130,000	310,000
PR	440,000	271,500	271,500	983,000
PE	96,000	75,000	70,000	241,000
PZ	258,000	379,000	407,000	1,044,000
GJI	120,000	135,000	150,000	405,000
GJA	0	0	165,000	165,000
MIT	0	0	0	0
Total	964,000	990,500	1,193,500	3,148,000
Miratimet e ARRU-së				
FE	50,000	130,000	130,000	310,000
PR	440,000	271,500	271,500	983,000
PE	143,995	159,715	171,333	475,043
PZ	258,000	379,000	407,000	1,044,000
GJI	120,417	117,503	123,729	361,648
GJA	184,322	130,539	143,970	458,831
MIT	192,201	197,901	201,831	591,933
Total	1,388,935	1,386,157	1,449,363	4,224,455
Sfidimi nga ARRU në vlerë monetare				
FE	0	0	0	0
PR	0	0	0	0
PE	47,995	84,715	101,333	234,043
PZ	0	0	0	0
GJI	417	-17,498	-26,271	-43,352
GJA	184,322	130,539	-21,030	293,831
MIT	192,201	197,901	201,831	591,933
Total	424,935	395,657	255,863	1,076,455
Sfidimi nga ARRU në përqindje				
FE	0%	0%	0%	0%
PR	0%	0%	0%	0%
PE	50%	113%	145%	97%
PZ	0%	0%	0%	0%
GJI	0%	-13%	-18%	-11%
GJA	NA	NA	-13%	178%
MIT	NA	NA	NA	NA
Total	44%	40%	21%	34%

Shtojca 6. Analiza e investimeve kapitale (ujë)

Tabela 6.1 Investimet kapitale të realizuara nga KRU për shërbimet e ujit nga burimet vetjake të financimit

KRU	2022	2023	2024	Totali
FE	83,256	148,354	310,425	542,035
PR	525,526	701,477	762,013	1,989,016
PE	381,219	409,283	1,169,117	1,959,619
PZ	594,062	493,986	691,741	1,779,789
GJI	133,123	170,908	421,796	725,827
GJA	600,850	915,233	666,116	2,182,199
MIT	5,246	79,147	116,999	201,392
Total	2,325,308	2,920,415	4,140,235	9,379,877

Tabela 6.2 Investimeve kapitale për shërbimet e ujit nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	823,000	755,000	850,000	2,428,000
PR	6,715,000	4,715,000	4,345,000	15,775,000
PE	1,038,000	867,000	807,000	2,712,000
PZ	1,101,500	1,236,000	1,405,000	3,742,500
GJI	1,663,600	508,000	2,008,739	4,180,339
GJA	1,396,081	1,542,000	1,930,350	4,868,431
MIT	328,005	420,000	615,000	1,363,005
Total	13,067,212	10,045,027	11,963,117	35,069,275
Miratimet e ARRU-së				
FE	732,035	661,580	614,808	2,008,423
PR	4,701,392	4,028,600	3,641,363	12,371,355
PE	719,676	713,419	738,015	2,171,110
PZ	774,710	813,032	889,812	2,477,554
GJI	534,586	449,290	593,541	1,577,417
GJA	1,214,039	1,160,189	996,374	3,370,602
MIT	828,309	764,303	825,183	2,417,795
Total	9,504,747	8,590,413	8,299,096	26,394,256

Shtojca 7. Analiza e investimeve kapitale (ujëra të ndotur)

Tabela 7.1 Investimet kapitale të realizuara nga KRU për shërbimet e ujërave të ndotura nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2022	2023	2024	Totali
FE	14,461	16,178	5,156	35,794
PR	190,957	44,333	68,848	304,138
PE	13,494	112,348	151,362	277,204
PZ	6,360	1,321	103,396	111,077
GJI	8,797	109,669	53,866	172,332
GJA	2,806	15,264	11,430	29,500
MIT	119	4,710	12,250	17,079
Total	239,016	305,846	408,332	947,124

Tabela 7.2 Investimeve kapitale për shërbimet e ujërave të ndotura nga burimet vetjake të financimit

Aplikimi nga KRU				
KRU	2026	2027	2028	Totali
FE	70,000	160,000	320,000	550,000
PR	1,435,000	1,150,000	1,150,000	3,735,000
PE	340,000	250,000	260,000	850,000
PZ	530,000	555,000	640,000	1,725,000
GJI	442,000	185,000	150,000	777,000
GJA	0	19,800	601,910	621,710
MIT	0	0	0	0
Total	2,819,026	2,321,827	3,123,938	8,258,710
Miratimet e ARRU-së				
FE	70,000	160,000	320,000	550,000
PR	1,435,000	1,150,000	1,150,000	3,735,000
PE	187,995	234,715	261,333	684,043
PZ	530,000	555,000	640,000	1,725,000
GJI	211,092	167,503	123,729	502,324
GJA	184,322	150,339	280,880	615,541
MIT	192,201	197,901	201,831	591,933
Total	2,810,610	2,615,458	2,977,773	8,403,841

Shtojca 8 Ndikimi i përgjithshëm tarifor i rregullimeve të ARRU-së (ujë)

Tabela 8.1 Rregullimet e përgjithshme të ARRU-së në përcaktimet finale të tarifave (UJË)

KRU	KRU-të me të dhëna përkatëse	2026	2027	2028	Totali
BIFURKACIONI	Aplikimi	0.5001	0.5599	0.5636	0.5412
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0547	-0.0588	-0.0622	-0.0586
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0145	-0.0467	-0.0480	-0.0268
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0082	-0.0203	-0.0283	-0.0189
	Të tjera	0.0606	0.0841	0.0936	0.0794
	Miratimet e ARRU-së	0.5123	0.5181	0.5187	0.5164
PRISHTINA	Aplikimi	0.7360	0.7343	0.7792	0.7498
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0304	-0.0722	-0.1115	-0.0714
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	-0.0713	-0.0241	-0.0246	-0.0400
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0075	-0.0186	-0.0253	-0.0171
	Të tjera	-0.0185	-0.0103	-0.0058	-0.0115
	Miratimet e ARRU-së	0.6082	0.6093	0.6119	0.6098
HIDRODRINI	Aplikimi	0.3876	0.3901	0.3830	0.3869
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0133	-0.0368	-0.0613	-0.0371
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0073	0.0085	0.0114	0.0091
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	-0.0001	-0.0002	-0.0003	-0.0002
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0046	-0.0103	-0.0152	-0.0100
	Të tjera	0.0015	0.0246	0.0547	0.0270
	Miratimet e ARRU-së	0.3785	0.3760	0.3723	0.3756
HIDROREGIONI- JUGOR	Aplikimi	0.6837	0.6883	0.6972	0.6898
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.1164	-0.1224	-0.1320	-0.1236
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	-0.0348	-0.0428	-0.0509	-0.0428
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0025	-0.0062	-0.0105	-0.0064
	Të tjera	0.0144	0.0136	0.0188	0.0156
	Miratimet e ARRU-së	0.5445	0.5305	0.5228	0.5326
HIDROMORAVA	Aplikimi	0.7594	0.6819	0.8132	0.7515
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.1069	-0.1066	-0.0908	-0.1014
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	-0.0526	-0.0116	-0.1857	-0.0833
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	-0.0013	-0.0024	-0.0031	-0.0022
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0110	-0.0203	-0.0272	-0.0195
	Të tjera	-0.0640	-0.0357	-0.0140	-0.0379
	Miratimet e ARRU-së	0.5236	0.5053	0.4925	0.5071
GJAKOVA	Aplikimi	0.5736	0.5741	0.6559	0.6012
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0775	-0.0830	-0.0893	-0.0833
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	-0.0200	-0.0255	-0.1022	-0.0492
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0012	-0.0064	-0.0127	-0.0068
	Të tjera	0.0254	0.0459	0.0638	0.0450
	Miratimet e ARRU-së	0.5002	0.5051	0.5155	0.5070
MITROVICA	Aplikimi	0.7464	0.7436	0.7297	0.7399
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.1122	-0.1388	-0.1425	-0.1312
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0399	0.0115	0.0166	0.0226
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0021	-0.0042	-0.0066	-0.0043
	Të tjera	-0.1616	-0.1005	-0.0903	-0.1175
	Miratimet e ARRU-së	0.5103	0.5115	0.5070	0.5096

Shtojca 9 Ndikimi i përgjithshëm tarivor i rregullimeve të ARRU-së (ujëra të ndotur)

Tabela 9.1 Rregullimet e përgjithshme të ARRU-së në përcaktimet finale të tarifave (UJËRA TË NDOTURA)

KRU	KRU-të me të dhëna përkatëse	2026	2027	2028	Totali
BIFURKACIONI	Aplikimi	0.1440	0.1626	0.1666	0.1577
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0101	-0.0130	-0.0157	-0.0129
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0082	-0.0203	-0.0283	-0.0189
	Të tjera	0.0032	0.0157	0.0219	0.0136
	Miratimet e ARRU-së	0.1289	0.1450	0.1445	0.1395
PRISHTINA	Aplikimi	0.2456	0.2225	0.2278	0.2320
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0232	-0.0193	-0.0263	-0.0230
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0075	-0.0186	-0.0253	-0.0171
	Të tjera	-0.0923	-0.0725	-0.0684	-0.0777
	Miratimet e ARRU-së	0.1226	0.1121	0.1078	0.1142
HIDRODRINI	Aplikimi	0.1526	0.1530	0.1530	0.1529
	Rregullimet për shpenzimet operative	0.0045	-0.0024	-0.0101	-0.0027
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0060	0.0107	0.0128	0.0099
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	-0.0001	-0.0002	-0.0003	-0.0002
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0046	-0.0103	-0.0152	-0.0100
	Të tjera	-0.0091	0.0025	0.0166	0.0033
	Miratimet e ARRU-së	0.1494	0.1533	0.1568	0.1532
HIDROREGIONI- JUGOR	Aplikimi	0.1851	0.2079	0.2155	0.2028
	Rregullimet për shpenzimet operative	0.0085	0.0063	0.0012	0.0053
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0025	-0.0062	-0.0105	-0.0064
	Të tjera	-0.0080	-0.0109	-0.0118	-0.0102
	Miratimet e ARRU-së	0.1832	0.1971	0.1943	0.1916
HIDROMORAVA	Aplikimi	0.1634	0.1997	0.2316	0.1982
	Rregullimet për shpenzimet operative	-0.0058	-0.0163	-0.0434	-0.0218
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0001	-0.0035	-0.0049	-0.0028
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	-0.0013	-0.0024	-0.0031	-0.0022
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0110	-0.0203	-0.0272	-0.0195
	Të tjera	-0.0052	0.0040	0.0178	0.0055
	Miratimet e ARRU-së	0.1402	0.1613	0.1708	0.1574
GJAKOVA	Aplikimi	0.0756	0.0775	0.1033	0.0855
	Rregullimet për shpenzimet operative	0.0853	0.0950	0.0922	0.0908
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0234	0.0174	-0.0028	0.0127
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0012	-0.0064	-0.0127	-0.0068
	Të tjera	-0.0064	0.0031	0.0093	0.0020
	Miratimet e ARRU-së	0.1767	0.1866	0.1894	0.1842
MITROVICA	Aplikimi	0.0939	0.0894	0.0892	0.0909
	Rregullimet për shpenzimet operative	0.0348	0.0336	0.0333	0.0339
	Rregullimet për përtëritjen e infrastrukturës	0.0167	0.0166	0.0168	0.0167
	Rregullimet për rritjen/zgjerimin e infrastrukturës	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
	Rregullimet për jo-infrastrukturë	-0.0021	-0.0042	-0.0066	-0.0043
	Të tjera	-0.0135	-0.0069	-0.0046	-0.0084
	Miratimet e ARRU-së	0.1298	0.1286	0.1280	0.1288

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Gazmend Zajmi, Nr. 85-87

E-mail: info@arru-rks.org

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>